



# Dukagjini

**Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Viti i XXIV i botimit, nr. 271, MAJ 2026**

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: [www.shoqatadukagjini.com](http://www.shoqatadukagjini.com), Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 100 lekë / 1 euro

## 2 U përkujtua me madhështi datëlindjen e Heroit tone Kombëtarë, Gjergj Kastriotit!

Data 6 maji duhet të jete festë kombëtare! Kjo ishte motoja jon, me datën 6 maj 2026, në kryeqytetin e republikës së Kosovës, në Prishtinë!

Me datën 6 maj 2026, ditën e Merkur, në Prishtinë u organizua një manifestim mbar kombëtar, me rastin e 621 vjetorit të lindjes së kryeheroit tone kombëtar Gjergj Kastrioti (Skënderbeu), ku morën pjesë qindra qytetar nga mbare trojet shqiptare dhe nga diaspora, me një kërkesë drejtuar qeverise së republikës së Kosovës dhe qeverise së republikës së Shqipërisë, që data 6 maj të shpallet festë mbarëkombëtare, me një ligj të posaçëm. Manifestimi u thirr nga Shoqata “Shqiptaria”, me qendër në Prishtinë.

Ishte viti i tret rresht, që organizohej një manifestim i tille, por sivjet pak ma ndryshe se vitet e tjera, pasi këtë vit veprimtaria u zgjeruan edhe ma shumë se vitet e tjera, duke filluar në qytetin e Lezhës dhe duke marshuar me një kolon makinash dhe motorësh nëpër rrugën e kombit drejt Prishtinës. Dita ishte shumë e ngjeshur me veprimtari, duke filluar nga mëngjesi në Lezhë e duke përfunduar në mbrëmje vonë në Prishtinë.

Me një grup artistësh, këngëtarësh dhe personalitetesh nga Shkodra ishim pjesëmarrës në këtë manifestim mbarëkombëtar. Në manifestim kishin ardhur nga të gjitha trevat shqiptare dhe nga diaspora!

Sheshi Gjergj Kastrioti, në qendër të Prishtinës ishte zbukuruar si për feste, në të cilin qindra qytetar kaluan gjithë pasditen, duke parakaluar e festuar. Vërtete ishte dite pranvere sikur kishte edhe emrin Shëngjergji i pranverës, sepse në këtë dite kishte lindur ky burrë ndaj i kishin vendosur emrin Gjergj...



## Kurrë mos të harrojmë vendlindjen

Vendlindja është vendi ku fillon jeta jonë, ku hedhim hapat e parë dhe ku krijohen kujtimet më të bukura të fëmijërisë. Edhe kur largohemi larg saj, ajo mbetet gjithmonë në zemrën tonë si një copëz e paharruar e shpirtit.

Nostalgjia për vendlindjen është një ndjenjë e thellë mallëngjimi që zgjohet sa herë kujtojmë rrugët, njerëzit dhe vendit ku u rritëm.

4

## Promovohet libri “Shqipëria Veriore (1878–1918) dhe Impakti i Fuqive Evropiane”

Në ambientet e Bibliotekës së Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër u promovua sot botimi “Shqipëria Veriore (1878–1918) dhe Impakti i Fuqive Evropiane”, një vëllim që përmbledh punimet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare të organizuar në tetor të vitit 2024. Botimi është realizuar me mbështetjen e Konsullatës së Nderit të Austrisë në Shkodër dhe është publikuar nga Shtëpia Botuese “Fishta”.

Libri trajton një prej periudhave më përcaktuese për historinë politike dhe shoqërore të Ballkanit, duke sjellë analiza dhe interpretime mbi zhvillimet e viteve 1878–1918 dhe ndikimin që Fuqitë Evropiane ushtruan në rajon gjatë kësaj kohe. Përmes qasjeve të ndryshme akademike, vëllimi synon të kontribuojë në një lexim më të thelluar dhe të balancuar të historisë së Shqipërisë Veriore dhe të Ballkanit në tërësi.

3

## Zef Shoshi - piktori i identitetit...

Zef Shoshi (19. 02. 1939 –) përfaqëson një nga figurat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese të pikturës shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XX. Krijimtaria e tij përbën një dëshmi të gjallë të zhvillimeve artistike në Shqipëri, duke reflektuar një ndërthurje të qëndrueshme midis realizmit figurativ, portretit dhe peizazhit, si dhe një ndjeshmëri të thellë në shoqërore dhe kulturës popullore.

6

# U përkujtua me madhështi datëlindjen e Heroit tone Kombëtarë, Gjergj Kastriotit!

Data 6 maji duhet të jete festë kombëtare! Kjo ishte motoja jon, me datën 6 maj 2026, në kryeqytetin e republikës së Kosovës, në Prishtinë!

Me datën 6 maj 2026, ditën e Merkur, në Prishtinë u organizua një manifestim mbar kombëtar, me rastin e 621 vjetorit të lindjes së kryeheroit tone kombëtar Gjergj Kastrioti (Skënderbeu), ku morën pjesë qindra qytetar nga mbare trojet shqiptare dhe nga diaspora, me një kërkesë drejtuar qeverisë së republikës së Kosovës dhe qeverisë së republikës së Shqipërisë, që data 6 maj të shpallet festë mbarëkombëtare, me një ligj të posaçëm.

Manifestimi u thirr nga Shoqata "Shqiptaria", me qendër në Prishtinë.

Ishte viti i tret rresht, që organizohej një manifestim i tille, por sivjet pak ma ndryshe se vitet e tjera, pasi këtë vit veprimtaria u zgjeruan edhe ma shumë se vitet e tjera, duke filluar në qytetin e Lezhës dhe duke marshuar me një kolon makinash dhe motorësh nëpër rrugën e kombit drejt Prishtinës.

Dita ishte shumë e ngjeshur me veprimtari, duke filluar nga mëngjesi në Lezhë e duke përfunduar në mbrëmje vonë në Prishtinë.

Me një grup artistësh, këngëtarësh dhe personalitetesh nga Shkodra ishim pjesëmarrës në këtë manifestim mbarëkombëtar.

Në manifestim kishin ardhur nga të gjitha trevat shqiptare dhe nga diaspora!

Sheshi Gjergj Kastrioti, në qendër të Prishtinës ishte zbukuruar si për feste, në të cilin qindra qytetar kaluan gjithë pasditen, duke parakaluar e festuar.

Vërtete ishte dite pranvere sikur kishte edhe emrin Shëngjergji i pranverës, sepse në këtë dite kishte lindur ky burrë ndaj i kishin vendosur emrin Gjergj simbas traditës mija vjeçare në trojet Shqiptare!

Fillimisht u be parakalimi i grupeve dhe këngëtarëve përgjatë gjithë sheshit me kostume kombëtare, pastaj filloj paraqitja e programit simbas planit të organizatorëve.

Së pari, u ligjërua, u mbajtën kumtesa dhe u përcollën studime për lindjen dhe jetën e Gjergj Kastriotit nga studiues dhe historian të ndryshëm nga të gjitha trevat tona.

Pastaj filloj programi artistik me këngë e valle shqiptare dhe arbëreshe kryesisht kushtuar kryetrimin tone, ishin ardhur këngëtarët ma të mirë të kombit, të cilët ishin: Nikoll Nik Prela, ilir Shaqiri, Kastriot Tusha e Selami Kolonja; ansamli "Rugova", nga Maqedonia e Veriut dhe veçanërisht një grup Arbëreshësh, që kënduan dhe vallëzuan deri vonë.

Nga Shkodra kishin ardhur këngëtar nga Shoshi: rapsodi Gjon Kosteri, nga Shala Leo Masheqaj, nga Pulti Pëllumb Demaj, nga Nikaj Merturi lahutari Vuk-san Mrishaj, të cilët promovuan një folklor krejt tradicional, me këngën maja krahu, këngë me lahutë, me sharki e çifteli, që u duartrokkit vazhdimisht.

Një e veçantë ishte dhe nderimi i Gjen-



eral (p) Hysen Gecit, me titullin "Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini", me motivacion: "Për kontributin e dhëne

në vijimësi për çështjen kombëtare, në çlirimin e Kosovës nga pushtuesi Serb; në lëvizjen për nderimin e heroit tonë



kombëtar, Gjergj Kastrioti dhe për bashkëpunimin e vijueshëm me Shoqatën Atdhetare Dukagjini". Titullin e nderit e dorëzoi anëtar i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", z. Mhill Shkami, i cili në mes të tjerave theksoj: "Kënaqësi dhe emocion i veçante, që në emër të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", përfaqësuese e një zone, e cila mbarte vlerat e traditat më të mira historike e tradicionale Shqiptare, të dorëzoi kolonel Hysni Gecit, këtë titull nderi, për heroizmin dhe kontributin e Tij në UÇK – në, për çlirimin e Kosovës. Fale kolonel Gecit dhe "Gecevet" të tjerë të UÇK-së, që sakrifikuuan gjithçka edhe jetën, për pavarësi e liri dhe që kemi sot, të cilët realizuan një objektiv, një pjesë të ëndrrës së Heroit tone kombëtarë, Gjergjit të madh, që po e përkujtojmë sot, këtu në mes të Dardanisë tone, jena këtu sot si kurrë ndonjë here në histori, të gjithë bashke si vëllezër në këtë dite të Shëngjergjit, para këtij monumenti madhështorë të Gjergj Kastriotit. Zemrat e çdo shqiptari kudo në bote janë me ne këtu sot, në këtë date të veçante, ku Zoti i dhuroi kombit tone një personalitet të pashoq në histori, Gjergjin e Madh. Ëndërrimë e shpresojmë, që këtë date ta festojmë edhe në trojet e tjera shqiptare, të cilat fatqësisht, të lëna jashtë dy shteteve tona, si këtu afër në Preshevë, në Tetovë, në Plave e Guci, në Ulqin, Tuz e Tivare, në Çamërinë tone, dëshirë kjo e çdo shqiptari.

Gëzuar e mirënjohje të gjithëve!

Respekt e mirënjohje te veçante për Arbëreshët e ardhur këtu, për të festuar me ne, enkas nga Italia mike!"

Në fund u shtrua një darke për të ftuarit special.

Ishte një dite me shumë kujtime dhe mbresa që duhet vazhdua!

Në orët e vona të natës u kthyem në Shkodër, duke marr me vete shumë kujtime dhe mbresa, të cilat gjate do të jene në mendjen tone!

Lavdi për jete kryetrimin ton legjendar Gjergj Kastrioti!

Gjithashtu urojme, që shpejti kjo date të kthehet në festë Kombëtare!

**Përgatiti Gjon Kosteri,  
Prishtinë, me 6 maj 2026**



# Promovohet libri “Shqipëria Veriore (1878–1918) dhe Impakti i Fuqive Evropiane”

Në ambientet e Bibliotekës së Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër u promovua sot botimi “Shqipëria Veriore (1878–1918) dhe Impakti i Fuqive Evropiane”, një vëllim që përmbledh punimet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare të organizuar në tetor të vitit 2024. Botimi është realizuar me mbështetjen e Konsullatës së Nderit të Austrisë në Shkodër dhe është publikuar nga Shtëpia Botuese “Fishta”.

Libri trajton një prej periudhave më përcaktuese për historinë politike dhe shoqërore të Ballkanit, duke sjellë analiza dhe interpretime mbi zhvillimet e viteve 1878–1918 dhe ndikimin që Fuqitë Evropiane ushtruan në rajon gjatë kësaj kohe. Përmes qasjeve të ndryshme akademike, vëllimi synon të kontribuojë në një lexim më të thelluar dhe më të balancuar të historisë së Shqipërisë Veriore dhe të Ballkanit në tërësi.

Konferenca nga e cila lindi ky botim ishte fryt i bashkëpunimit ndërmjet Konsullit të Nderit të Austrisë në Shkodër, z. Gjergj Leqeja, Dom Nike Ukgjinit dhe Departamentit të Historisë të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, me kujdesin e veçantë të Prof. Dr. Nertila Haxhia Ljarja. Në të morën pjesë studiues dhe akademikë nga vende të ndryshme të rajonit, të cilët prezantuan punime të mbështetura në dokumente arkivore dhe materiale kërkimore, shpesh të pabotuara më parë. Pikërisht kjo larmi këndvështrimesh dhe interpretimesh e bën këtë vëllim një kontribut të rëndësishëm për debatin historiografik bashkëkohor.

Ceremonia e promovimit mblodhi përfaqësues të jetës akademike, kulturore dhe institucionale të Shkodrës dhe më gjerë.



Në fjalën e tij hapëse, organizatori kryesor, z. Gjergj Leqeja, theksoi rëndësinë e trajtimit të historisë përmes dialogut shkencor dhe mirëkuptimit ndërkombëtar, duke nënvizuar se qëllimi i këtij botimi është të ndihmojë në ndriçimin e fakteve historike përmes një qasjeje serioze akademike.

Rektori i Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Prof. Dr. Tonin Gjuraq, e vlerësoi botimin

si një kontribut me vlerë për bibliografinë shkencore shqiptare dhe për forcimin e bashkëpunimit akademik ndërkombëtar. Të pranishëm në aktivitet ishin gjithashtu Prefektja e Qarkut Shkodër, znj. Holta Duda, pedagogë, studiues, studentë dhe qytetarë të interesuar për historinë dhe kulturën.

Paneli shkencor i promovimit përbëhej nga Prof. Dr. Nail Draga, Prof. Dr. Ner-

tila Haxhia Ljarja dhe Dom Nike Ukgjini, të cilët diskutuan mbi temat kryesore të trajtuara në vëllim. Diskutimet u ndalën veçanërisht te kontributet e autorëve shqiptarë, perspektivat e studiuesve malazezë dhe qasjet e autorëve turq mbi periudhën osmane, duke evidentuar rëndësinë e dialogut akademik ndërmjet shkollave të ndryshme historiografike.

Periudha 1878–1918, nga Kongresi i Berlinit deri në përfundimin e Luftës së Parë Botërore, konsiderohet një nga fazat më vendimtare në formësimin e hartës politike të Ballkanit modern. Vendimet dhe zhvillimet e asaj kohe vazhdojnë të kenë ndikim edhe sot në marrëdhëniet politike, historike dhe identitare në rajon. Në këtë kuadër, botimi synon të ofrojë një kontribut serioz në pasurimin e diskutimit publik dhe akademik mbi këto zhvillime historike.

Vëllimi është botuar nga Shtëpia Botuese “Fishta”, e njohur për kontributin e saj në botimet akademike dhe studimore shqiptare. Libri do të jetë i disponueshëm për publikun me një çmim simbolik prej 10 eurosh, ndërsa të ardhurat e mbledhura do të shkojnë në mbështetje të Bibliotekës Austriake në Shkodër, për pasurimin e fondit të saj kërkimor dhe shkencor.

Promovimi i këtij botimi përbën jo vetëm një aktivitet kulturor e akademik, por edhe një dëshmi të rolit që Shkodra vazhdon të luajë si qytet i dialogut, kulturës dhe mendimit kritik. Përmes nis-mave të tilla, historia kthehet në një urë komunikimi dhe reflektimi për të tashmen dhe të ardhmen.

Përgatiti zj. JONA LEQEJZA

## Fjala e Konsullit të Nderit të Republikës së Austrisë, në Shkodër, z. Gjergj Leqeja



Të nderuar pjesëmarrës,  
Miq e të ftuar,

Para së gjithash dëshiroj të falënderoj për zemërsisht të gjithë ato që mundësuan zhvillimin në kushte të shkëlqyera ketë

veprimtari promovuese, ku dëshiroj të përmendi Bibliotekën Austriake!

Kështu, që edhe një here faleminderit!

Siç e kam shprehur edhe në përshëndetjen time, në Konferencën e zhvillueme në ambientet e Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Ballkani pjese e së cilës është Shqipëria, historikisht ka qene shesh i konflikteve, pretendimeve e ndikimit të “Fuqive të mëdha”, duke filluar nga ajo Romake e deri te fuqitë e vona e te sotme Evropiane dhe me gjere.

E si rezultat i këtyre kjo zone vazhdon te jete ne një “situate potenciale konfliktuale” ku here mbas here dalin në pah problematikat nder-etnike, religjioze a territoriale, që për mendimin tone ndikojnë në cenimin e stabilitetit dhe paqes ndërmjet vendeve e popujve tone, të cilat janë aq të nevojshme e të kërkuara nga

shumica absolute e popujve e institucioneve te politikes së vendeve tona, Evropiane e botërore.

Për këtë, bashke me mikun tim Dom Nike Ukgjini e drejtuesit e Katedrës së Historisë së Universitetit të Shkodrës, menduam të organizojmë një Konferencë Shkencore, ne të cilën u prezantuan referime të ndryshme nga studiues të vendeve të Ballkanit bazuar në materiale ndoshta të pabotueme deri atëherë e të interpretuara nga këndvështrime të ndryshme, një pjese cilësore e të cilëve janë prezentë sot ... e që gjej rastin ti përshëndes.

Sot jemi mblledhë për të promovue botimin e këtyre referencave në një vëllim modest, që shpresojmë do të shtohet në bibliotekën e studiuesve e jo vetëm, dhe mendojmë që po modestisht do të vlejje për njohjen e fakteve historike, lidhjeve e këndvështrimeve të ndryshme ndaj tyre, por gjithnjë si e kam theksua edhe ma pare, qëllimi asaj konference, e sidomos botimi i punimeve te saj, nuk është absolutisht tendenca e rishikimit të historisë

e përdorimi I shembujve të së kaluarës, për tç krijuar e nxite polemika jo konstruktive (karakteristike për Ballkanin), por përkundrazi me qëllimin e mirë për të evidentuar e ndriçuar fakte historike të tilla, që me të “përbashkëtat” të ecim përpara në rrugën pa kthim të integritimit në familjen e madhe Evropiane.

Me këtë rast dëshiroj të falënderoj për zemërsisht “Entin Botues Fishta”, për bashkëpunimin e sidomos miqtë e mi bashkëpunëtorë Dom Nikë Ukgjini, Prof .Dr. Nertila Ljarja, z. Gjovalin Çuni e të tjerë, për idenë e punën e pakursyere për realizimin e këtij botimi ....

Dhe se fundi, por jo nga rëndësia një falënderim për të gjithë ju që gjetet kohen për të qene të pranishëm në këtë promovim, të cilit i uroj sukses.

Në tavolinë ka libra për të gjithë dhe çmimi i mundshëm është 10 euro (kush dëshiron), shumë cila do të shkoje në favor të Bibliotekës Austriake, për rritjen e fondit kërkimor e shkencor të saj.

Faleminderit...

# Kurrë mos të harrojmë vendlindjen



Vendlindja është vendi ku fillon jeta jonë, ku hedhim hapat e parë dhe ku krijohen kujtimet më të bukura të fëmijërisë. Edhe kur largohemi larg saj, ajo mbetet gjithmonë në zemrën tonë si një copëz e

paharruar e shpirtit.

Nostalgjia për vendlindjen është një ndjenjë e thellë mallëngjimi që zgjohet sa herë kujtojmë rrugët, njerëzit dhe aromën e vendit ku u rritëm.

Sa herë mendoj për vendlindjen time, më vijnë ndër mend ditët e lumtura të fëmijërisë. Kujtoj oborret plot gjallëri, zërat e fëmijëve që luanin pa u lodhur dhe mbrëmjet e qeta pranë familjes. Çdo cep i atij vendi ka një kujtim të veçantë: rrugicat ku kam ecur, pemët nën hijen e të cilave kam pushuar dhe njerëzit e thjeshtë që gjithmonë të prisnin me buzëqeshje.

Edhe pse koha kalon dhe jeta na çon në vende të ndryshme, vendlindja mbetet gjithmonë e shenjtë. Ajo nuk është vetëm një vend në hartë, por një pjesë e identitetit tonë. Malli për të bëhet më i madh kur jemi larg, sepse atëherë kuptojmë vlerën e saj të vërtetë. Kujtimet e saj na japin forcë dhe ngrohtësi shpirtërore në momentet e vështira.

Nostalgjia për vendlindjen na kujton se rrënjët tona janë aty ku kemi lindur e jemi rritur. Pavarësisht se ku na çon jeta, zemra gjithmonë kthehet tek ai vend i dashur që quhet vendlindje.

## VENDLINDJA NA THËRRET

Në zemër je rrënjë e pashuar, mall që s'shuhet në asnjë udhëtar.

Edhe larg kur na çon kjo jetë, zëri yt na flet i qetë:

“Mos më harro, bijtë e mi, se këtu nisën ëndrrat, dashuritë e fëmijërisë. Këtu toka mban hapat tuaj, dhe era njuh emrat tuaj.”

Vendlindja është plagë e ëmbël, këngë që s'harrohet kurrë.

Na thërret në çdo stinë, si nënjë që pret te dera pa u lodhur.

“Mund të ikim larg, por zemra gjithmonë kthehet aty ku nisi jeta”.

Ne kujtim te vendlindjes aty ku rreh zemra, disa emigrante nga fshati Xhan, të Njësisë Administrative Pult, Bashkia Shkodër, të cilët jetojnë në SHBA, organizuan një manifestim madhështor me date 16.05. 2026, në qendër të fshatit Xhan, në mjedisin e kishës së Shënkollit, në të cilën morën pjesë rreth 500-banore e të ftuar. Aty, për të gjithë ishte përgatitur dreka modeste me të gjitha ushqimet bio ashtu siç jemi mësuar gjithmonë.

Kjo ishte një dite e veçantë, sepse dashuria për vendlindjen nuk pyet për kushtet atmosferike jo të mira. Prandaj edhe pse ishte shi edhe ere të gjithë kërcyen e vallëzuan nen tingujt e muzikës folklorike tradicionale .

Në koncert ishin te ftuar Deputetja e Dukagjinit znj. Marjana Koçeku, e cila mbajti fjalën, falënderoj dhe motivoj organizime te tilla; përfaqësuesi i dioqezës Shkodër-Pult Dom Vlash Palaj, i cili me falet e tije bekoj të gjithë të pranishmit , si dhe shume personalitete të tjera nga Shkodra e diaspora.

Koncerti ishte i mirë organizuar nga organizatorët dhe ishin të ftuar ;

-Nga Malësia e Madhe, zj. Elvira Fierza.

-I ardhur posaçërisht nga Italia, këngëtarë Agron Tefa si dhe -Grupi “TREVA“, me këngëtarët Ndue Shytani, Fran Kodra, Sokol Gjoni si dhe këngëtarja e re nga Xhani, znj. Angelina Prroni.

Veprimtari të tilla sjellin jo vetëm argëtimin e të pranishmeve. por rrisin dashurinë për vendlindjen, rrisin rrahjet e zemrës për vendin tone, për vendlindjen tone, aty ku shohim ëndrrat e fëmijërisë .

Respekt i veçantë për mundëtorët e këtij manifestimi.

Zoti jua shpërbleftë me shëndet e leke! Paçin e dhënçin gjithmonë për mire!

Përgatiti **GJOVALIN KODRA**

## Kuvendi Kombëtar Shqiptar

Kuvendi Kombëtar Shqiptar (Tiranë, 2 maj 2026) bashkoi shqiptarë nga të gjitha trojet dhe diaspora, nën frymën e unitetit kombëtar.

Në sallën e mbushur me atdhedashuri, delegatë, intelektualë, artistë e veprimtarë riafirmuan aspiratën historike për bashkim dhe vetëvendosje.

Himni Kombëtar dhe fjala e personaliteteve shqiptare sollën emocione të forta dhe kujtesën e sakrificave ndër shekuj.

U miratua njëzëri Rezoluta për Bashkimin Kombëtar Shqiptar, si thirrje demokratike për të drejtat historike të kombit shqiptar.

Diskutimet u përqendruan te padrejtësitë e copëtimit të trojeve shqiptare dhe nevoja për ruajtjen e identitetit kombëtar.

Kuvendi dëshmoi se shqiptarët, kudo që jetojnë, mbeten të lidhur nga gjuha, kultura dhe kujtesa historike.

Poezia, kënga dhe fjala artistike e kthyen këtë ngjarje në një manifestim të shpirtit kombëtar shqiptar.

Ky Kuvend vjen si një dëshmi se historia e kombit ndërtohet mbi kujtesën, dashurinë për atdheun dhe besimin në një

të ardhme më të bashkuar.

I nderuar Gjergj Leqejza u zgjodh në Kryesinë e këtij Kuvendi!

### ROZA PJETRI



# Pleqnia si institucion shoqnor e demokratik!



Dua përsëri t'i kthehem organizimit shoqnor tradicional në trevat tona të vjetra, jo si kthim nostalgjik në të kaluemen, por si thirrje e ndërgjegjes mbi nevojën për një ma të fortë qytetar, bashkësore dhe politik në Shqipëri.

Jetojmë në një kohë ku, sipas mendimit tëm, çorientimi publik, dobësimi i organizimit civil dhe rënia e përgjegjësisë bashkësore kanë marrë përmasa shqetësuese. Shoqnia jonë shpesh duket e shpërndame, e lodhën, e pambrojtun përballë pushtetit, interesave të ngushta dhe vendimmarrjeve që merren larg qytetarit. Pikërisht për këtë arsye, kthimi te disa forma të vjetra të organizimit tonë shoqnor nuk është thjesht ushtrim historik, por nevojë për me kuptue se mbi çfarë parimesh mund të ndërtohet një jetë publike ma e përgjegjshme.

Në ndihmë të këtij mendimi po sjell përsëri organizimin tonë tradicional, një formë që elita kombëtare e ka njoftë, e ka vlerësue dhe e ka përmendë edhe në dokumente ndër ma të randësishmet të historisë sonë shtetformuese. Bahet fjalë për pleqninë.

Po kthehem në vitin 1925, te raporti i Komisionit të Statutit, i lexuem në Kuvendin Kushtetues, në mbledhjen ku u diskutue forma e regjimit të shtetit shqiptar, një raport qe u miratua me shumicë. Në atë raport, ndër argumentet ma të randësishme për shpalljen e formës republikane të shtetit, gjendet edhe një argument që lidhet drejtpërdrejt me natyrën shoqnore të shqiptarit dhe me institucionin e pleqnisë.

Ky argument nuk mbështetet vetëm mbi parime juridike, as vetëm mbi shembuj të shteteve të hueja, por mbi vetë përvojën historike të shoqnisë shqiptare. Raporti thotë, në thelb, se shqiptari në shpirt është demokrat, dhe këtë e lidh me pleqninë, me gjyqin e pleqnisë, me autoritetin moral të saj dhe me pranimin që ajo ka pas në popull.

Duke jua lanë juve të lirë ta lexoni dhe ta peshoni vetë si argument, unë

besoj se kjo pjesë prek një të vërtetë të thellë historike. Në shumë treva shqiptare, para se shteti modern të kishte shtritur plotësisht dorën e vet administrative, pleqnia ka qenë institucioni kryesor i vetërregullimit shoqnor. Ajo nuk ka qenë thjesht një mbledhje zotnish të ditun, të vjetër në moshë, dhe shume të nderuem, por një formë përgjegjësie kolektive, ku fjala, nderi, kujtesa e vendit dhe interesi i përbashkët kishin peshë ma të madhe se urdhni i thatë.

Unë vij prej një zone ku pleqnia ka qenë, për shumë kohë, institucioni themelor i diskutimit dhe i zgjidhjes së çështjeve jetësore që lidheshin me ekzistencën, mbarëvajtjen dhe ruajtjen e trevës. Ajo ka qenë vullnetare në formë, por e detyrueshme në ndërgjegje. Nuk mbështetej mbi polici, burg apo dhunë shtetnore, por mbi autoritetin e fjalës së dhanun, mbi besimin e bashkësisë dhe mbi përgjegjësinë morale ndaj vendit.

Pikërisht për këtë arsye, lufta ma e madhe kundër pleqnisë ka ardhë gjithmonë prej sistemeve autoritare. Çdo pushtet që synon me e përqendruet të gjithë autoritetin në dorën e vet, nuk mund ta durojë një institucion shoqnor që gëzon besim para shtetit, që ndërmjetëson pa urdhën politik dhe që ruan një kujtesë të pavarun prej propagandës zyrtare. Në këtë kuptim, goditja ma e randë iu ba pleqnisë nga sistemi diktatorial i Enver Hoxhës, i cili e pa parinë, pleqninë dhe autoritetet tradicionale si pengesa kritike për ambicien e tij për kontroll të plotë mbi shoqinë. Histori që vazhdon me pushkatime, burgosje dhe persekutime.

Në kujtesën time familjare, kjo ka mbete e lidhun me një thanie të gjyshit tim. Gjyshi ka qenë përkthyes në kohën e Austrisë dhe shoqnuet i shumë ekspeditave në periudhën mbas Luftës së Parë Botnore deri në çlirimin e Shqipnisë. Në vitet '80, kur isha ende i vogël në prehnin e tij, Baba e pyeti se si kishte mundësi gjithë ajo dhunë dhe gjithë ajo luftë kundër pleqnisë e parisë.

Gjyshi iu përgjigj me një fjali:

**“Mos me pasë kenë paria dhe pleqnia, asnjë pëllambë tokë s'i kishte mbetë këtij vendi nën emnin shqiptar!”**

Pleqnia, si çdo institucion njerëzor, ka pas kufizimet e veta. Ajo ka funksionue në kohë, rrethana dhe struktura shoqnore që nuk janë të njëjta me botën e sotme. Por thelbi i saj; diskutimi i hapun, ndërmjetësimi, përgjegjësia para bashkësisë, kërkimi i pajtimit dhe pranimi i vendimit nga vetë njerëzit, mbetet një vlerë që i flet drejtpërdrejt demokracisë moderne.

Demokracia e sotme nuk mund të kuptohet vetëm si votim një herë në katër vjet. Ajo kërkon pjesëmarrje, këshillim, kontroll shoqnor mbi vendimmarrjen, ndërmjetësim mes palëve dhe institucione që

e lidhin qytetarin me çështjet publike. Pa këto, demokracia mbetet formë pa përmabajtje, ligj pa besim, institucion pa shpirt.

Në këtë kuptim, pleqnia, e mendueme në frymë bashkëkohore, mund të lexohet si një formë e hershme e demokracisë vendore, e drejtësisë pajtuese dhe e vetëqeverisjes bashkësore. Jo si model që duhet kopjue mekanikisht, por si frymë organizimi, përgjegjësie dhe ndërgjegjeje publike.

Ajo që dikur quhej pleqni mund të kuptohet sot si një shkollë e hershme e demokracisë shqiptare.

Dhe pikërisht prej këtu lind pyetja që duhet me ia ba vetes sot:

A jemi sot mjaftueshëm të organizuem përballë botes dhe demokracive moderne?

Me këtë pyetje po postoj më poshtë një pjesë nga raporti zyrtar i mbajtur në Kuvendin Kushtetues të vitit 1925.

\*\*\*

## Pjesë nga raporti zyrtar

Viti i I, Tiranë 1925, Nr. 32  
BISEDIMET E KUVENDIT KUSH-TETUES

Mbledhja 66.

E Mërkurë, me 21. I. 1925, ora 2.30 m. dr. E Kryeson Z. Eshref Frashri.

Këndohen emnat e Misëve të K. Kush-tetues e mungojnë Z. Z. Abdyl Kuçi, Ali Këlcyra, Ambroz Malaskaj, Aqif Elbasani (me leje) Bahri Omari, Bektash Çorushi, Dervish Mitrovica, Dr. Fahri Rashid, Fan Noli, Fasli Frashëri, Hafis Repishti, Hafis Ismeti, Hoxha Kadriu (vdiq), Ibrahim Gjyrezi, Ilias Mutka, Ismail Tatzati, Jan Paphopullo, Kol Tromara, Kostaq Paftali, Lon Lozori, Luigj Koliqi, Luigj Gurakuqi, Mustafa Trajzi, Don Ndre Mjeda, Nikol-laq Zoi, Numan Ferizi, Nush Bushati, Osman Myderrizi, Pandeli Evangjeli, Pjetër Bumçi, Qazim Koculi, Rasim Babameta, Sami Koprencka, Sejfi Vllamasi, Spiro Koleka, Shuk Gurakuqi, Sulejman Delvina, Shefqet Fishta e Xhemal Bushati.

Z. KRYETARI: Shumica është mbledhja hapet.

Z. KRYETARI: Bisedim mbi caktimin e formës së rrëgjimit të Shtetit.

Këndohet raporti i Komisionit të Shtetit si pason:

Mbas bisedimeve të gjata që u bënë në Komisionin e Statutit, Komisija u nda në grupe, Republikan e Monarkist. Na Republikanët, tue u bazuem me arsyenat posht tregueme kemi bindjen e plotë se fatbardhësija e Kombit e Shqiptar nuk mund të sigurohet, veç se me zbatimin e sistemit Republikan.

ARSYENAT

I

Gjendja Historike

Monarkiët kan për bazë parimin Theokratik traditat e një familjes mbretnore, qi ka qenë sundues n' atë vend, ose shkaqe të tjera Historike.

Në Shqipni nuk ka ndo një familje Mbretnore, qi të ket pretendime theokratike, nuk ka as ndonji dinasti Kombtare tjetër qi të kët të drejta tradicionale.

Dinastija e Wilhelmit I. me largimin e tij nga Shqipija dhe me të marrunit pjesë në luftën e përgjithshme nen flamurin e një kombit të huej, humbi të drejten qi i kishin dhanë mbi fronin e Shqipnis.

Kështu, edhe një herë, është vertetue se s' pëtimtarët e një Kombi, për herë, kan dalë nga gjiri i popullit dhe kur nuk kan ardhë së jashtmi.

Veç kësaj koha e sotrishme nuk është aspak e dobishme për krijimin e dinastive, kur që dinastija të vjetra, me renja shekullore janë rrëzue e janë shduke.

Pra traditat e vjetra të racës Shqiptare, dhe gjendja historike, na ç liron nga barra e Monarkies, që shumica e Kombeve të faqes dheut, janë ç' barros prej sajë dhe na tregon rrugën e Republikës.

II

## Gjendja shoqnore

Shqiptari në shpirt është demokrat. Të gjithë të huajtë qi kan ardhur në Shqipni, kjo gjendje, u ka tërheqë vretjen, aqë, sa e kan shenjue edhe në librat qi kan botuem mbi udhëtimet e tyre, nuk munden të ç' duken nga shpirti Shqiptarit, bindjen e përjetshme qi ka pas para pleqësis.

Kuer qi vendimet e Gjyqit e pleqësis, pa mos pas asnji fuqi zbatuese, përherë kan qenë pëlqye e nderue prej popullit dhe ato të Gjyktorëve Zyrtare të huaja, as me fuqi 95%, nuk mund të zbatohin.

Pra një sistem pleqësimi d. m. th. Republika Demokratike është një sistem, qi mburon nga shpirti e nga jetë shoqnore e Shqiptarit, dhe Monarshija është në kundërshtim të plotë me natyrën e tij.

Gjendja shoqnore e Shqipnis tregon se e vetmja formë shtetnore, qi mund ti përshatet Shqiptarit demokrat në shpirt është Republika.

\*\*\*

Na mos të heqim dore kurr nga Plakoni e Strabonit, nga pleqësija, të cilen e kemi rrujtun edhe deri sot, se kurë do Pleqesija urdhnon në Shqipnië.

Pleqesija t' urdhnojnë e të mbretnojnë gjithë një.

3 Prille 1924

Kryetari i Partisë Republikës  
Komisioni i Statutit  
P. POGA

Përgatitë nga Dr. Mark Rupa

# Zef Shoshi - piktori i shpirtit shqiptar ndërmjet realizmit dhe identitetit kulturor



Nga GJON MARKU

Zef Shoshi (19. 02. 1939 –) përfaqëson një nga figurat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese të pikturës shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XX. Krijimtaria e tij përbën një dëshmi të gjallë të zhvillimeve artistike në Shqipëri, duke reflektuar një ndërthurje të qëndrueshme midis realizmit figurativ, portretit dhe peizazhit, si dhe një ndjeshmëri të thellë ndaj jetës shoqërore dhe kulturës popullore. Në këtë kuadër, arti i Shoshit nuk mund të shihet thjesht si një praktikë estetike, por edhe si një formë e rëndësishme e dokumentimit të realitetit historik dhe kulturor shqiptar.

Që në vitet e hershme të jetës, Shoshi dëshmoi një prirje të spikatur për artin figurativ, e cila u zhvillua më tej gjatë formimit të tij akademik në Institutin "Ilya Repin" në Leningrad, një nga qendrat më prestigjioze të artit realist në Evropë, si dhe më pas në Institutin e Arteve në Tiranë. Ky formim i dyfishtë, që ndërthur traditën akademike lindore me realitetin shqiptar, ndikoi ndjeshëm në kon-

solidimin e gjuhës së tij artistike të bazuar në realizmin figurativ, karakteristik për shkollën lindore të artit (1).

Ndikimi i të atit dhe kontakti i hershëm me veprat e mjeshtërive klasikë, si Leonardo da Vinçi, ndikuan në formimin e një disipline artistike të qëndrueshme (2).

Kontributi i tij në pikturën shqiptare nuk kufizohet vetëm në aspektin teknik, megjithëse mjeshtëria e tij në përdorimin e dritës, hijes dhe ngjyrës është e padiskutueshme. Ai shquhet veçanërisht për aftësinë për të depërtuar në botën e brendshme të subjektit, duke pasqyruar jo vetëm pamjen e jashtme, por edhe dimensionin psikologjik dhe emocional të figurës njerëzore. Kjo e bën krijimtarinë e tij një ndër shembujt më të spikatur të portretit realist shqiptar. Në këtë kuadër, arti i tij lidhet me traditën e realizmit evropian (3).

Portreti zë një vend qendror në veprën e Shoshit. Nëpërmjet tij, ai arrin të ndërtojë figura me identitet të qartë, ku çdo detaj - nga vështrimi të qëndrimi trupor - kontribuon në krijimin e një narrative të brendshme. Kjo qasje e bën portretin e tij jo vetëm një paraqitje fizike, por një studim të karakterit njerëzor. Në këtë kuadër, realizmi i portretit të Enver Hoxhës në vitin 1974 përbën një moment të rëndësishëm në karrierën e tij, duke reflektuar njëkohësisht kërkesat ideologjike të kohës dhe aftësinë profesionale të artistit.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i krijimtarisë së Shoshit është trajtimi i peizazhit. Peizazhet e tij nuk janë thjesht përshkrime të natyrës, por interpretime poetike të saj. Në mënyrë të veçantë, rajoni i Zadrimës zë një vend të privilegjuar në veprën e tij, ku fusha të gjera, lumenj të qetë dhe relieve të buta kodrinore paraqiten me një ndjeshmëri të hollë kromatike dhe një ndërtim të balancuar kompozicional. Këto peizazhe shprehin një lidhje të thellë emocionale të artistit me vendlindjen dhe hapësirën shqiptare dhe identitetin kulturor (4).

Vizatimet e tij të hershme, veçanërisht ato të realizuara në Ulqin, ku ai paraqet anije dhe horizonte detare, dëshmojnë për një vëzhgim të mprehtë dhe një disiplinë të hershme në ndërtimin e formës. Këto punë fillestare hedhin bazat e një zhvillimi të mëvonshëm artistik të qëndrueshëm dhe koherent.

Gjatë periudhës së komunizmit, krijimtaria e Shoshit u zhvillua brenda kornizës së realizmit socialist, i cili përbente metodën zyrtare të artit. Në këtë kontekst, ai realizoi një sërë veprash që trajtonin jetën e klasës punëtore dhe të fshatarësisë, duke paraqitur figura të angazhuara në punë dhe në aktivitetet prodhuese. Këto kompozime, përveç vlerave artistike, kanë edhe rëndësi dokumentare historike dhe artistike (5), pasi ofrojnë një pasqyrë të jetës sociale dhe ekonomike të kohës.

Vetë artisti shpreh një vetëdije të qartë për përkatësinë e tij estetike dhe historike, kur thotë: "Nuk e di, unë di që kam nisur të pikturoj që kur isha 5 vjeç (që i bie viti '44) dhe vazhdoj të pikturoj ende sot, por e ndjej që i përkas kohës së realizmit socialist. Unë jam gatuar në atë kohë, punën më të madhe e kam bërë në atë kohë, i përkas asaj kohe." Ky pohim dëshmon ndërgjegjësimin e tij për ndikimin e kontekstit historik në formimin e identitetit artistik.

Një dimension i rëndësishëm i veprës së Shoshit është edhe trajtimi i kulturës popullore. Në shumë prej kompozimeve të tij paraqiten elemente të jetës tradicionale shqiptare, si veshjet popullore, zakonet dhe ritualet, të cilat jo vetëm që kanë vlera estetike, por edhe kontribuojnë në ruajtjen e identitetit kulturor e të trashëgimisë kulturore (6). Në këtë mënyrë, arti i tij merr një funksion të dyfishtë: estetik dhe etnografik.

Pas rënies së komunizmit, krijimtaria e Shoshit u çlirua nga kufizimet ideologjike dhe filloi të vlerësohej më gjerësisht në arenën ndërkombëtare. Ekspozimi i veprave të tij jashtë Shqipërisë, veçanërisht në Shtetet e Bashkuara, dëshmon për uni-

versalitetin e gjuhës së tij artistike dhe për aftësinë e tij për të komunikuar me publikun ndërkombëtar përtej kontekstit ideologjik në të cilin u formula (7). Në këtë kuptim, ai mund të konsiderohet si një ndër përfaqësuesit më të rëndësishëm të artit shqiptar në kontekstin global.

Në planin stilistik, Shoshi arrin të ndërthurë realizmin me një ndjeshmëri të theksuar individuale, duke i dhënë veprës së tij një dimension emocional dhe psikologjik të spikatur. Figura njerëzore mbetet në qendër të kësaj qasjeje, duke u trajtuar me kujdes dhe thellësi, çka e bën krijimtarinë e tij të dallueshme dhe të qëndrueshme në kohë.

Në përfundim, Zef Shoshi përfaqëson një nga shtyllat kryesore të pikturës shqiptare bashkëkohore. Kontributi i tij konsiston në ndërtimin e një ure lidhëse midis traditës artistike dhe zhvillimeve moderne, duke krijuar një trashëgimi të pasur dhe të qëndrueshme. Veprat e tij vazhdojnë të jenë një burim frymëzimi për artistët e rinj dhe një objekt studimi për kritikën dhe historinë e artit, duke e vendosur atë në mënyrë të merituar në panteonin e artit shqiptar.

## Literatura:

1. Akademia e Arteve e Shqipërisë, Historia e artit shqiptar, Tiranë, 2003, f. 215.
2. Agim Faja, Arti figurativ shqiptar 1945–1990, Tiranë, 2004, f. 132.
3. Alfred Uçi, Estetika dhe arti shqiptar, Tiranë, 1986, f. 98.
4. Ferid Hudhri, Arti shqiptar ndër shekuj, Tiranë, 2001, f. 276.
5. Shaban Hadëri, Realizmi socialist në artin shqiptar, Tiranë, 1978, f. 54.
6. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Kultura popullore shqiptare, Tiranë, 2002, f. 189.
7. Gazmend Leka, Arti shqiptar pas viteve '90, Tiranë, 2010, f. 67.

GJON MARKU



# Kush po dëshiron ta helmojë popullin shqiptar në heshtje?

Nuk jam fajtores që shoh më larg se ata që rrinë ulur në errësirë. Nuk jam fajtores që nuk pajtohem me padrejtësitë, pazaret e pista dhe heshtjen që po vret popullin tim. Faji nuk është i imi që flas drejtë. Faji është i atyre që heshtin, kur duhet të ngrihen. Unë nuk i trembem fjalës së lirë. Ajo është arma ime, mburoja ime dhe drita e ndërgjegjes sime. Mund t'i burgosësh njerëzit, por zërin e atyre që kanë ndërgjegje nuk mund ta shuash kurrë. Dhe unë jam prej tyre.

Dua ta nderoj me përlulesi dhe krenari Musine Kokalarin, shkrimtaren e parë shqiptare, simbolin e pathyeshmërisë. E burgosën 20 vite, e lanë pa familje, pa mjekim, pa dritë. U përpoqën ta thyenin, por nuk mundën. Ajo u la historisë një amanet që nuk shuhet kurrë: "Faji im është se nuk mundën të ma ndalin "fjalën e lirë.""

Sot, kjo fjali është kampionë që bie për gjithë kombin shqiptar: Mos heshtni! Sepse kur hesht populli, rritet përbindëshi i korrupsionit dhe tradhtisë.

Rinia po ikën!

Ajka e kombit po largohet!

E ndërkohë sistemi që e quajnë "demokratik" është bërë një fasadë boshe: zero ligj, zero drejtësi, zero moral, zero dashuri për tokën tonë. Dhe çfarë po ndodh sot? Po ndodh ajo më e rënda: "Fqinjët serbë", të cilët historikisht kanë dashur ta dëmtojnë e ta zhdukin nga faqja e dheut kombin tonë, sot po bashkëpunojnë me disa biznesmenë shqipfolës, të cilët për interesa të tyre personale po fusin në treg jo vetëm misër të helmuar, por edhe miell të dyshimtë, mish të kontaminuar dhe shumë produkte të tjera ushqimore të rrezikshme.

Kjo nuk është thashetheme.

Kjo nuk është teor!

Kjo është realiteti i hidhur që po futet në shtëpitë tona. Helm për bagëtinë. Helm për tokën. Helm për fëmijët tanë. Helm për popullin shqiptar. Dhe politika shqiptare në përgjithësi po Heshtë. Heshtë, sepse interesi i biznesit po qëndron mbi jetën e popullit.

Dhe ja e vërteta më e dhimbshme: Edhe pse disa herë janë kapur qindra tonë misër të helmuar në dogana, tregtia vazhdon. Po ashtu dyshohet që po vazhdojnë të hynë edhe gjera të tjera, ushqimore të dyshimta e të rrezikshme si të ishin dhurata, e që janë helm për popullin tonë.

Kur një shtet hesht përballë helmimit të kombit të vet, kjo nuk quhet heshtje. Kjo quhet krim shtetëror dhe kombëtar.

Nuk do të bëhem pjesë e turmës që rrjedh me lumë. Prandaj unë nuk do të hesht.

Fjala e lirë është zjarr. Është forcë. Është mburojë. Është identitet.

Dikush duhet t'ua thotë të vërtetën në sy. Dhe unë do ta them e do ta shkruaj të vërtetën gjithmonë derisa ky vend të vetëdukohet.

Populli im nuk do të helmohet nga

dora gjakatare e shkau pa u përballur me zërin tonë.

## Kush po shet Patriotizëm dy dite para festes Kombëtare: Patriotet apo tradhtarët?

Ata që nuk respektojnë heronjtë, dëshmorët, vlerat e kombit dhe luftëtarët e lirisë, të mos shesin patriotizëm në ditë festash!

Ka njerëz që e kujtojnë kombin vetëm kur afrohen festat. Dalin me flamuj nëpër duar, bëjnë thirrje për atdhedashuri dhe shesin fjalë të mëdha, sikur kanë mbajtur mbi supë gjithë historinë tonë.

Por në ditët e zakonshme, këta të njëjtët nuk njohin as vlerat kombëtare, as sakrificat, as gjakun e dëshmorëve.

Patriotizmi nuk zgjohet vetëm dy ditë në vit. Nuk është dekor për fotografi, as maskë për të fshehur interesat personale. Patriotizmi është përgjegjësi, është sjellje e përditshme, është respekt.

E mbi të gjitha, është nderimi i atyre që dhanë jetën për këtë tokë, heronjtë dhe dëshmorët tanë.

Prandaj, para se të na shesin patriotizëm në prag festash, pyetne veten:

Ku ishit gjithë vitin?

Çfarë respekti treguat, cilën vlerë e

mbrojtët, cilin ideal e nderuan?

Kombin nuk e duan ata që bëjnë zhurmë për dy ditë. Kombin e duan ata që e respektojnë në heshtje, çdo ditë.

Ata që nuk njohin vlerat kombëtare, që nuk respektojnë historinë, që nuk përuken para emrit të heronjve, le të mos na shesin patriotizëm.

Sepse patriot është ai që jeton për kombin, jo ai që e përdorë kombin për përfitimite.

Andaj, është ironike me pa sot ata që deri dje putheshin me shkaun, me turkun, me grekun e me rusin... e sot bëjnë statuse me flamur, sikur po i ndez zemra për Shqipërinë.

Për një "like" te shkajut dje fluturonin nga gëzimi, sot flasin për kombin me një zell që t'i bën nervat copë.

Janë të njëjtët që kanë pas jarani, kumari dhe bashkëpunime me armiqtë tanë, njerëz që çdo ditë na kanë shkatërruar shpirtërisht.

E sot, me fytyrën më të ndyrë, ngrijnë flamurin kuq e zi që deri dje e përdhosën.

Ata që dëgjonin me adhurim këngët sllave, që përqafojnë serbofilët, që u serviloseshin faqezinjve, për përfitimite të tyre, sot pozojnë si patriotë.

Hipokrizi që të bën me vjellë.

Këta servil po harrojnë masakrat: fëmijët e prerë, gratë shtatzëna të vrara, pleqtë e djegur si në hell nga Serbia ne tokën Dardane.

Po, harrojnë se, sot po nderohen shqipfolësit andej e këndej kufirit, spiunet dhe tradhtarët e kombit, e pikërisht ju jeni ata që po i ngrijnë në pedestal, si të ishin vlera kombëtare.

Kurse brezat para jush: stërgjyshe, gjyshër, baballarë e vetë ju, keni kontribuar e po kontribuoni ende, në tkurrjen e trojeve tona.

Keni bërë hile e keni bashkëpunuar me serbin, vetëm për t'i shpëtuar fytyratë e juaja të ndyra.

E sot, shisni patriotizëm për 28 Nëntor.

E mbuloni Facebook-un me flamuj, poezi e brohoritma, sikur nuk iu kemi parë deri dje të zhytur në baltë.

Për shkak tuajin, për shkak të gjithkujt që nuk e njohu shtetin, kombin, dëshmorët, heronjtë, luftëtarët e lirisë; për shkak të patriotizmit të rremë dhe tradhtisë,

DLIRIA jonë u nda në 7 pjesë, e sundohet nga armiqtë e përveçëm shekullor të kombit tonë.

Prandaj, një herë e mirë:

MOS SHISNI MORAL PATRIOTIK.

MOS BËNI SIKUR JU KA LINDUR KOMBI SHQIPTAR DY DITË PARA FESTËS.

Ne i dimë fytyrat e juaja, të moralit e "patriotizmit" historik dhe servilosjet e juaja, heshtni mjaft më.

LAVDIA i takon vetëm atyre që nuk u përlyen kurrë!

## Kombi nuk shkelet për karrierë!

Maji i luleve nuk është për ata që zemrën e kanë të plagosur çdo ditë të vitit. Por është për ata që dhimbjen e luftës e kanë parë vetëm në televizione apo e kanë dëgjuar nga të tjerët. Dhimbja që nuk përjetohet në lëkurën tënde harrohet lehtë, por jo për ata që humbën familjarët e tyre në luftë, masakra e gjenocid.

Më së shumti lëndohen familjet shqiptare kur shohin se disa media, televizione, profesorë, akademikë, poetë e shkrimtarë shqiptarë sot shesin moral për patriotizëm, ndërsa në anën tjetër promovojnë e ngritin në pedestal shkrimet, poezitë etj, të serbëve, malazezëve, rusëve, grekëve e të tjerë që historikisht kanë sjellë lot, pushtime, masakra e gjakderdhje mbi popullin shqiptar, vetëm e vetëm të duken bukur të ndërkombeëtare e h.

Të gjithë e dimë se liria e Dardanisë-Kosovës, nuk erdhi me fjalë, por me gjak, sakrificë, lot, masakra, djegie, zhdukje e dhunime të grave, fëmijëve dhe pleqve shqiptarë nga agresori serbë. Prandaj është e rëndë kur disa intelektuale shqiptarë drejtor të disa medimeve me name, në Kosovë e Shqipëri për karrierën e tyre, afirmim apo interesa personale, përkëdhelin e madhërojnë ata -



# Letërsi e Zemrës dhe e Kujtesës

RECENSION LIBRI



Dr. Migena Arllati

Kjo përmbledhje prozash të shkurtër e autorit Tahir Bezhani, paraqet një botë narrative të ndërtuar mbi përvojën njerëzore në kufijtë e saj më të ndjeshëm: mërgimin, vetminë, kujtesën, ndarjen familjare dhe rrjedhën e pandalshme të kohës. Në qendër të të gjitha tregimeve qëndron njeriu i zakonshëm prindi, mërgimtari, fshatari, i moshuari, i vendosur përballë ndryshimeve shoqërore dhe historike që shpesh e tejkalojnë. Tematikisht, vepra krijon një mozaik të dhimbjes kolektive dhe individuale. Mërgimi i të rinjve, prishja e lidhjeve familjare, vetmia e pleqërisë dhe pasojat e luftës janë motive të përsëritura që ndërtojnë një univers të qëndrueshëm emocional. Në disa tregime, si ato me Hasanin, Mentorin, Dritonin apo Durimin, njeriu shfaqet si bartës i kujtimeve dhe i një nostalgjie të thellë për një rend shoqëror që po zbehet.

Stilistikisht, autori Bezhani shquhet për një gjuhë të pasur emocionale, shpesh të ngarkuar me figuracion tradicional dhe një ton elegjiak. Rrëfimi është linear dhe

i qartë, me prirje për të ndjekur rrjedhën kronologjike të ngjarjeve, duke i dhënë lexuesit një ndjenjë të vazhdueshme dëgjimi të një "rrëfimi gojor" të jetës. Dialogjet bëhen një element i rëndësishëm i strukturës narrative dhe shërbejnë si bartës të mendimeve filozofike dhe morale të personazheve.

Megjithatë, një karakteristikë e dukshme e stilit është prirja drejt zgjerimit emocional dhe përsëritjes së ideve, sidomos në refleksionet e brendshme të personazheve. Kjo e forcon ndjeshmërinë e tekstit, por në disa raste e ngadalëson ritmin narrativ dhe e zhvendos peshën nga veprimi konkret drejt meditimit të gjatë. Po ashtu, përdorimi i gjuhës shpesh mbetet brenda një regjistri tradicional, me pak eksperimentim strukturor apo stilistik modern.

Në aspektin artistik, pesëmbëdhjetë tregimet e këtij vëllimi kanë një vlerë të qartë dokumentare dhe shoqërore: ato ruajnë kujtesën e një kohe, të një mjedisi dhe të një gjenerate që përballlet me transformime të mëdha.

Autori shfaqet si rrëfimtari i ndjeshëm i realitetit të përditshëm, me një prirje të fortë për empati dhe për ndërtimin e figurave njerëzore të besueshme dhe të afërta.

Në tërësi, kjo përmbledhje prozash përbën një dëshmi letrarë të jetës së përjetuar dhe të kujtesës kolektive, ku forca qëndron më shumë në ndjeshmërinë e rrëfimit dhe autenticitetin e përvojës sesa në ndërtimin e ngjeshur formal të tregimit modern. Ajo mbetet një letërsi e zemrës dhe kujtesës, që synon të ruajë zërin e njeriut të thjeshtë në kohë ndryshimesh të mëdha shoqërore.

vet është e rëndë.

Populli shqiptar ndër shekuj ka vuajtur nga pushtuesit e okupatorë të ndryshëm: turq, serbë, rusë, grekë e të tjerë, por edhe pas gjithë asaj historie dhimbjeje, disa ende përpiqen ta zbehin të vërtetën dhe ta minimizojnë gjakun e derdhur për liri.

Muaji maj dhe shumë muaj të tjerë në Dardani- Kosovë, janë muaj dhimbjeje, përkujtimi, kujtese për heroizmin e dëshmorëve, masakrat, djegiet, zhdukjet e dhunimet që përjetoi populli ynë. Historia nuk duhet harruar dhe as dhimbja e familjeve shqiptare të përdoret për interesa personale.

Nëse duam të jemi një komb i fortë, duhet t'i ruajmë me fanatizëm vlerat tona kombëtare dhe sakrificën për liri. Sepse vlerat e kombit mbrohen me vepra, jo me servilizëm.

## Altaret, që nuk pranojnë harrese

Tmerrin e pamë me sy,  
e bota na i mbylli veshët,  
Edhe sot, pas gjithë këtyre viteve,  
çdo cep toke flet me gjak, demet që i beri shkau.  
Reçaku, Qyshku, Meja, Krusha, Lybeniqi,  
Drenica, Mitrovica,  
qosh më qosh Kosovës,  
aty ku fjala shqipe merrte frymë.

\*\*\*

Tregimi "Ai e donte vdekjen" ndërtohet mbi një bosht të fuqishëm emocional dhe historik, duke e vendosur njeriun e pasluftës përballë dy përvojave themelore: kujtesës së traumës dhe ndërgjegjesimit për fundin e pashmangshëm. Në planin tematik, teksti trajton pasojat e luftës jo vetëm në dimensionin material, por sidomos në atë psikologjik dhe ekzistencial. Njerëzit që "nuk e njihnin njëri-tjetrin" dhe që kërkonin identitetin e humbur në fytyrat e ndryshuara, përfaqësojnë një shoqëri të çrrënjësuar, ku trauma ka prishur edhe marrëdhëniet më themelore njerëzore. Kjo gjendje shërben si sfond për zhvillimin e raportit mes dy personazheve kryesore, Memli Kodrës dhe Behar Shpatit, të cilët mishërojnë dy mënyra përballjeje me fatin: kërkimin e shpresës dhe pranimin e fundësisë.

Figura e Beharit është ndërtuar me një thellësi të veçantë simbolike. Ai përfaqëson intelektualin e goditur nga historia, poetin me frymë "migjeniane", që nga rebelimi kalon në një pajtim stoik me vdekjen. Deklarata e tij për sëmundenjen dhe pranimin e fundit nuk paraqitet si dorëzim, por si një akt i vetëdijshëm filozofik. Këtu qëndron edhe paradoksi i titullit: "Ai e donte vdekjen" nuk nënkupton dëshirë për shuarje, por një pranim të thellë, pothuaj etik, të saj si pjesë e jetës. Në anën tjetër, reagimi i Memlit është njerëzor, instinktiv dhe kundërshtues. Ai refuzon ta pranojë vdekjen e mikut, duke përfaqësuar kështu zërin e jetës dhe shpresës. Ky kontrast midis dy qëndrimeve krijon një tension filozofik që e ngrë tregimin përtej një historie personale, duke e bërë atë një reflektim mbi ekzis-

tencën njerëzore.

Kulmi emocional arrihet në fund, me njoftimin e vdekjes së Beharit. Zgjidhja narrative është e thjeshtë, por e fuqishme: një shtyllë mortore, një foto dhe një orar varrimi. Minimalizmi i kësaj skene e shton ndikimin e saj, duke lënë hapësirë për rezonancë të thellë emocionale. Përmbyllja me imazhin e mikut që "qëndron i varur në bebëzat e syve" është një metaforë e goditur për kujtesën si formë e pavdekësisë.

Tregimi "Dridhje e vonuar" ndërtohet mbi një motiv të njohur, por gjithmonë të fuqishëm letrar: rikthimin e papritur të dashurisë së dikurshme dhe përplasjen e saj me kohën, kujtesën dhe moshën. Autori e vendos ngjarjen në një ambient kulturor, një orë letrare, duke krijuar një hapësirë simbolike ku fjala artistike dhe përjetimi intim ndërthuren natyrshëm. Ky sfond nuk është i rastësishëm: është pikërisht aty, mes poetëve dhe krijimtarisë, ku ndjesitë e fjetura gjejnë terrenin për t'u rizgjuar.

Figura e Luljetës është ndërtuar me një theks të fortë estetik dhe sensual. Përshkrimi i saj është i ngarkuar me figura poetike dhe krahasime të natyrës, duke e afruar me një idealizim të bukurisë femërore, pothuaj mitike ("si një zanë mali"). Ajo nuk është thjesht një personazh, por një shenjë e kujtesës, një katalizator që zgjon një të kaluar të fjetur. Prania e saj është e mjaftueshme për të prishur ekuilibrin emocional të protagonistit dhe për ta kthyer atë në një udhëtim të brendshëm. Në aspektin psikologjik, tregimi është një analizë e ndjeshme e asaj që mund të quhet "nostalgji aktive", një gjendje ku e kaluara nuk është thjesht kujtim, por përjetim i ripërtërirë. Besniku nuk

serbët që dje ishin vrasësit dhe okupatorët tanë.

Nuk mund të derdhësh lot për dëshmorët, martirët dhe në të njëjtën kohë të promovosh ata që kryen krime mbi popullin shqiptar e me e keqja ne portalet, gazetat e juaja. Ai që e ngrit agresorin në pedestal, e vret për herë të dytë dhimbjen e familjeve te kategorive të luftës, popullin shqiptarë.

Ne dardanët kurrë nuk e kemi ndarë veten nga Shqipëria. Sepse kemi një gjak, një gjuhë, një flamur dhe një komb të përbashkët.

Por, fatkeqësisht disa intelektual, profesor, doktor, drejtor te mediave te shkruar dhe elektronike e akademik për famë e për interesa personale, po harrojnë plagët e kombit dhe po mundohen të bëhen "të mëdhenj", duke shkelur mbi sakrificën e popullit shqiptarë, vuajtjen dhe sakrificën që kanë bërë për lirinë e vendit.

Njeriu nuk vritet vetëm me plumb. Vrasja më e rëndë është kur plagën ta hapë, ta gërryen e ta helmojnë dyfish ata që e quajnë veten intelektual e që është nga gjaku yt.

Kur një shqiptar, apo shqipfolës mundohet të minimizon luftën, gjenocidin dhe vuajtjet që ka përjetuar populli i

Nuk kursyen as plakun në karrocë,  
as gruan me jetë në bark,  
as fëmijën në lulak,  
as nxënësin e klasës së parë,  
që ende s'dinte ç është urrejtja.

Çfarë u doli për dore, e bënë gjakpirësit serbë.  
Trupat i shndërruan në fusha krimi,  
nënat, motrat edhe nuset me duvak,  
në britmë që bota s'e dëgjoi, as tani.  
Pleqtë i dogjën të lidhur,  
kokë më kokë,  
sikur donin të shuanin kujtesën,  
jo vetëm jetën.

Kjo s'ishte luftë jo,  
ishte altar gjaku.  
Një gjenocid i ftohtë,  
i menduar mirë, i zbatuar, i heshtur nga Serbia!  
Lotët nuk shterren kurrë.

Prandaj pyes:  
a ka burrë që mund ta falë këtë krim?  
A ka zemër që shtrin dorën e pajtimit  
pa u dridhur nga eshtrat nën tokë?  
Kush ka fytyrë ta fshehtë mizorinë,  
e të ndërtojë të ardhmen mbi gjak,  
kur nëpër ara e male  
ende rrjedh,  
jo ujë, por gjak njeriu?  
Kush ka shpirt të thotë:  
"Koha kaloi"?  
Koha s'kalon mbi varre pa emër.

Jo.  
As unë nuk fal.  
Sepse isha flakë  
me ata që u shuan  
në altarët e lirisë.  
Heshtja ime s'është pajtim,  
është betim.  
Sepse kujtesa është drejtësi  
kur drejtësia mungon.  
Ne nuk jetojmë për të harruar,  
por për të dëshmuar.  
Dhe derisa kjo tokë të ketë frymë,  
emrat do të flasin,  
varret do të akuzojnë,  
e gjaku s'do të quhet kurrë ujë.  
Falja pa të vërtetën  
është tradhti ndaj të rënëve.  
E unë,  
jam zë i atyre që s'flasin më.  
Në altarët e lirisë  
nuk digjet urrejtja,  
digjet e vërteta.  
Dhe ajo  
nuk falet.

Prof. Kumrie Avdyll Shala,  
gazetare e poete, maj 2026

është vetëm një vëzhgues i së kaluarës së tij; ai e rijeton atë në mënyrë të plotë, deri në atë pikë sa realiteti përreth zbehet.

Përfundimi i tregimit është i qetë, reflektiv dhe simbolik. Imazhi përmblylës i “gjetheve të pathara në herbariumin e zemrës” është një metaforë e bukur për kujtesën emocionale që ruhet e paprekur nga koha.

**Tregimi “Ngatërresë me hatërmbetje”** ndërtohet mbi një bosht realist familjar, ku përplasja mes vëllezërve shndërrohet në një dramë të brendshme shoqërore dhe morale. Në qendër të tij qëndron familja Bregu, si një mikrokozmos i shoqërisë së pasluftës, ku ndryshimet e statusit, krenaria e tepruar dhe mungesa e komunikimit e çojnë lidhjen vëllazërore drejt ndarjes, e më pas drejt një pajtimi emocionalisht të fuqishëm.

Një nga vlerat kryesore të tregimit është ndërtimi i gradual i konfliktit. Autori nuk e vendos përçarjen si një akt të menjëhershëm, por si një proces të ngadalë që ushqehet nga lodhja, egoja dhe keqkuptimet e përditshme. Figura e Qëndrim Bregut paraqitet si shtylla morale e familjes: punëtor, i përkushtuar dhe i shqetësuar për unitetin familjar, ndërsa Graniti shfaqet si personazh i transformuar nga rrethanat e pasluftës, i kapur nga një ndjenjë e gabuar superioriteti dhe distancimi nga përgjegjësitë familjare. Ky kontrast krijon tension narrativ dhe njëkohësisht nxit reflektim mbi ndikimin e kohës dhe rrethanave në karakterin njerëzor.


Veçanërisht i arrirë është momenti i ndërhyrjes së natyrës në narracion. Skena me këlyshët e qenve që përpiqen të takohen përmes murit. Kjo skenë ka funksion të qartë simbolik: ajo shërben si pasqyrë morale për njerëzit, duke theksuar kontrastin mes instinktit të pastër të kafshëve dhe ndarjes së panevojshme njerëzore. Ky është momenti kulmor emocional i tregimit, ku autori arrin të lidhë natyrën me ndërgjegjen njerëzore dhe të krijojë një efekt të fortë empatik.

Tregimi “Ajo akoma qëndron në dritare” ndërtohet mbi një bosht të fortë psikologjik dhe emocional, ku gjendja e brendshme e personazhit kryesor, Besnikut, shndërrohet në qendër të rrëfimit. Autori e vendos lexuesin brenda një bote të trazuar shpirtërore, ku vetmia, pagjumësia dhe kujtimet e dashurisë së humbur krijojnë një atmosferë të rënduar ekzistenciale.

Një nga vlerat kryesore të tregimit është intensiteti emocional dhe ndërtimi gradual i krizës së brendshme të personazhit. Besniku nuk paraqitet thjesht si individ i lodhur nga jeta, por si një njeri i përfshirë në një konflikt të thellë mes kujtesës, ndjenjës dhe realitetit. Kjo e bën rrëfimin të afërt me prozën psikologjike, ku bota e brendshme ka më shumë peshë se veprimi i jashtëm.

Stili i autorit karakterizohet nga një gjuhë e ngarkuar me figuracion poetik dhe përshkrime të detajuara natyrore. Elementet e natyrës: vapa, pishat, era, drita e diellit etj., nuk janë vetëm sfond, por pasqyrojnë gjendjen emocionale të personazhit, duke krijuar një paralelizëm të qartë mes natyrës dhe shpirtit njerëzor. Kjo i jep tregimit një dimension liriko-narrativ.

Tregimi “Ara” ndërtohet mbi një subjekt të thjeshtë rural, por me një ngarkesë



të theksuar sociale dhe emocionale, ku përmes fatit të Hasan Malajt pasqyrohen tensionet e brendshme të njeriut të zakonshëm në realitetin pas ndarjes së pasurisë dhe prishjes së lidhjeve familjare. Vepra vendoset në një hapësirë tipike fshatare, ku natyra, stinët dhe puna e tokës nuk janë vetëm sfond, por bëhen pjesë aktive e gjendjes shpirtërore të personazhit kryesor.

Nga ana tematike, tregimi trajton konfliktin mes vëllazërisë dhe interesit, duke e vendosur Hasanin në një situatë të dhimbshme vetmie, varfërie dhe zhgënjimi. Ndarja me vëllain nuk paraqitet thjesht si akt ekonomik, por si plagë morale që e gërryen ngadalë protagonistin. Kjo e afron tekstin me një realizëm social, ku problematika familjare shndërrohet në metaforë të prishjes së harmonisë njerëzore në përgjithësi.

Personazhi i Hasanit është i ndërtuar me ngjyrim të fortë psikologjik: ai është i heshtur, i mbyllur në vetvete, i mbërthyer nga mërzia dhe pamundësia, ndërsa gdhendja e thuprave shërben si simbol i boshllëkut dhe i zëvendësimit të punës së vërtetë me një veprim të kotë, meditativ. Përballë tij, figura e vëllait Beka dhe e bashkëfshatarëve krijojnë një kontrast të qartë midis dhimbjes së brendshme dhe indiferencës apo hipokrizisë së jashtme.

Tregimi “Pendim i vonuar” ndërtohet mbi një bosht tematik të njohur të letërsisë bashkëkohore shqipe: mërgimin, përplasjen e vlerave tradicionale me ndikimet e huaja dhe krizën e identitetit familjar në diasporë. Autori e trajton këtë temë përmes një rrëfimi të drejtpërdrejtë, me ton reflektiv dhe moralizues, duke e vendosur personazhin Bardh Shkreta në qendër të përjetimit emocional dhe ideor.

Struktura narrative është lineare dhe e qartë, e ndërtuar mbi dialogë të gjatë që shërbejnë si bartës kryesorë të ideve. Përmes bisedës mes Bardhit dhe Mërgimit, teksti shndërrohet në një debat socio-kulturor mbi humbjen e lidhjes me atdheun, rrezikun e asimilimit dhe dobësimin e lidhjeve familjare në diasporë. Kjo i jep tregimit karakter eseistik, ku rrëfimi shpesh i afrohet trajtës së meditimit social më shumë sesa fabulës klasike narrative.

Personazhi i Bardhit është i konceptuar si bartës i vetëdijes kombëtare dhe familjare, ndërsa Mërgimi shërben si reflektim i përvojës së diasporës dhe dëshmitar i ndryshimeve shoqërore. Dialogu mes tyre

krijon tension ideor, por jo domosdoshmërisht konflikt dramatik të zhvilluar në mënyrë të thelluar, çka e mban tregimin më afër një rrëfimi reflektiv sesa një narrative me zhvillim të fuqishëm veprimi.

Tregimi “Rrëfimi për bacën Smajl” ndërtohet mbi një bosht tematik të njohur dhe të fuqishëm në letërsinë bashkëkohore shqiptare: mërgimin, kujtesën e vendlindjes dhe ruajtjen e identitetit përmes rrëfimit familjar. Autori e zhvillon ngjarjen jo përmes konfliktit të drejtpërdrejtë, por përmes kujtesës dhe rrëfimit brenda familjes, duke krijuar një atmosferë reflektuese dhe nostalgjike.

Në planin tematik, teksti fiton peshë sidomos në lidhjen që krijojnë mes brezave: babai (Gëzimi) dhe djali (Kujtimi). Kjo marrëdhënie shërben si urë transmetimi i vlerave kombëtare, kulturore dhe emocionale. Figura e bacës Smajl, edhe pse e pranishme fizikisht vetëm në kujtime, shndërrohet në simbol të lidhjes së njeriut me natyrën, me vendin dhe me autenticitetin e jetës rurale. Aftësia e tij për të imituar shpendët merr një dimension pothuaj mitik, duke e vendosur atë në kufirin mes reales dhe legjendës së fshatit.

Në aspektin simbolik, bacë Smajli funksionon si figurë e “kujtesës së gjallë të fshatit”, një lloj ruajtësi i harmonisë mes njeriut dhe natyrës. Vdekja e tij shënon jo vetëm fundin e një personi, por edhe një ndarje graduale të brezave me botën tradicionale.

**Tregimi “Konflikti i befte”** ndërtohet mbi një tablo të gjerë përshkruese të fshatit tradicional dhe mbi një konflikt të brendshëm shoqëror që lind nga krenaria dhe fjalët e tepruara mes dy familjeve të fuqishme. Forca e tregimit qëndron te atmosfera e odës burrërore, e cila është paraqitur me detaje tipike dhe me një ndjesi autenticiteti kulturor. Dialogu luan rol qendror në zhvillimin e konfliktit dhe në zbrërthimin e karaktereve, sidomos përmes përplasjes mes Hasan Qarrit dhe Ramadan Daijës, ku del në pah krenaria, autoriteti dhe ndjeshmëria e nderit tradicional.

Zgjidhja e konfliktit përmes figurës së Bylbyl Delisë dhe simbolikës së demave është pika më metaforike e tregimit. Ajo bart një mesazh të qartë pajtimi: kur natyra dhe instinkti i kafshëve nuk hyjnë në konflikt, aq më tepër njeriu duhet të shmangë përplasjet e panevojshme. Kjo e jep tregimit një fund moralizues dhe pa-

jtues.

Tregimi paraqet një tablo të qartë të jetës tradicionale dhe të mekanizmave të pajtimit në komunitetin rural, duke e vendosur theksin te vlera e urtësisë popullore dhe ndërmjetësimit si zgjidhje e konflikteve.

Tregimi “Ajo, flokëbardha” ndërtohet mbi një episod udhëtimi, ku përvoja e rastësishme në një autobus shndërrohet në bosht narrativ për të reflektuar mbi sjelljen njerëzore, moralin dhe kufijtë e komunikimit në hapësirën publike.

Në planin tematik, tregimi lëviz mes dy poleve: tërheqjes dhe refuzimit, afërsisë dhe distancës morale. Figura e Flokëbardhës ndërtohet si një personazh provokues, i cili nuk është thjesht individual, por edhe simbol i një bote urbane dhe “të lirë”, që bie ndesh me normat tradi-

cionale të personazhit kryesor dhe ambientit prej nga ai vjen. Kjo përplasje gjeneron tensionin kryesor të ngjarjes. Dialogët, sidomos mes plakës dhe Flokëbardhës, janë të gjallë dhe kontribuojnë në krijimin e konfliktit të menjëhershëm, duke e bërë skenën më dramatike.

Një element me vlerë është edhe korniza rrëfimore me Bardhylin dhe Burimin, e cila e shndërron përjetimin individual në një rrëfim të ndarë, pothuaj anekdotik, duke i dhënë tregimit funksion kujtese dhe rrëfimi gojor.

**Tregimi “Te dardha”** është një tregim me frymë romantike dhe ndjenjë të fortë, që mbështetet mbi një traditë të njohur tematike. Ai ndërtohet mbi një motiv klasik të prozës sonë: dashurinë rinore të penguar nga normat shoqërore dhe familjare, e cila kërkon realizim përmes sakrificës dhe fshehtësisë. Në qendër është figura e Bardhylit dhe Bardhës, dy të rinj që përjetojnë një dashuri të fuqishme, por të rrezikuar nga konteksti tradicional i fshatit.

Në planin tematik, teksti trajton përplasjen midis ndjenjës individuale dhe kontrollit shoqëror, një temë e njohur në letërsinë me sfond rural. Dashuria paraqitet si forcë instinktive, pothuaj e pashmangshme, ndërsa rrethanat sociale si pengesë e vazhdueshme. Elementi i “dardhës” si vendtakim ka funksion simbolik: ai shërben si hapësirë e fshehtë, kufi mes ndalesës dhe lirisë, duke e kthyer natyrën në dëshmitare të ndjenjës.

**Tregimi “Përgjuesi”** është një tregim me temë të qëndrueshme sociale dhe moralizuese, që trajton me realizëm pasojat e pushtetit të vogël, lakmisë dhe thashethemit në një komunitet të mbyllur. Ngjarja vendoset në një situatë të thjeshtë rurale, por me një bosht tematik të qartë: degradimin moral të individit kur pushteti i vogël i jepet dikujt pa maturi dhe pa vetëdije etike. Ngjarja vendoset në një fshat të thatësirës, ku konflikti për ujën bëhet shkak për ekspozimin e karaktereve dhe për prishjen e ekuilibrave shoqërorë.

Personazhi i Dinë Gungës është qendra e rrëfimit dhe shërben si një figurë tipike e transformimit negativ: nga njeri i besuar në komunitet, ai kalon në gjendje mendjemadhësie, më pas në sjellje devijante dhe përfundon në izolim moral. Ky degradim është paraqitur gradualisht dhe me motive psikologjike, veçanërisht

# Erdhe në jetë si “Kujtim” i bukur i familjes dhe u largove si “Kujtim” i paharruar për familjen e shoqërinë

(FJALA E RASTIT NË CEREMONINË MORTORE TE KUJTIM FUNIÇIT, ME 5/11/2026



Të nderuem të pranishem, pjesëmarrës në këtë ceremoni mortore të lamtumirës së fundit, të babës së mire, vëllait të pashoq, bashkëshortit të dashtun, shokut fisnik, mikut zemërbardhë, veprimtaritë të palodhun, djalit oremadh, dhe atdhetarit Kujtim Kole Funiçi!

Kujtimi lindi dhe u rrit në ashtën kreshnike të Dukagjinit ku lisat dhe retë rrokun njena tjetrën, atje ku Ora e Shalës ka folenë prej qindra vjetësh, ku kullat dhe burrat mbajnë historinë, ku besa ashte jeta dhe nderi, atje ku zemërbardhësia ashte e dëlirtë si bora e bjeshkëve, ku treveza ashte shtrueme për mikun e rrugëtarin, atje ku fisnikëria ashte në genet e racës së pastër ilire, tipare këto që Kujtimi i mësoi në familjen e tij, i promovoi dhe i lartësoi çdo dite e minute, gjate gjithë jetës së vet.

Kujtim Funiçi u lind me 7 Maj të vitit 1965, në një familje patriotike shaljane të Zef Ndout të Gimajve të Shalës, prej prindërve Kole Zef Funiçi dhe Line Prekes prej Abatit të Shalës.

Kujtimi ishte fëmija dhe gëzimi pare, pastaj familja rritet me: Vjollcën, Ardianin

dhe Arianen. Djali i madh Kujtimi, erdhi si dhurate gëzimi e mirësie në vigjilje të Shënkollit në maj, të viti 1965 dhe u thirre në amshim, po në të njëjtën javë, pas 61 vjetësh, por me emocione të vështira sot për familjen dhe miqtë e tij.

Filloi shkollën fillore në Breglumi, sepse familja e tij ishte vendosur për arsye punët, baba mësues dhe nena punonjëse në spital. Vazhdoi, po aty shkollën 8 vjeçare dhe ishim shoke klase, aty filloi shoqnia jonë, që pavarësisht rrugëve të ndryshme të jetës, vazhdoi deri me 3 Maj të këtij viti, ku u takuam për here të fundit në Bronx, në festimet për ditën e Gjergj Kastriotit, që ishte një prej mbështetësve dhe organizatorëve.

Dhe u ndamë me; shihemi në fund të javës ... por të Mërkurën, me 6 Maj e kuptova se ai kishte gjetur të tjerë miq, që ta festonte datëlindjen, duke na lanë të gjithëve në pikëllim.

Shkollën e mesme e mbaroi pa shkëputje nga puna, sepse e tërhoqi zanati i saldatorit, për 3 vjet në Hydrocentralin e Komanit deri sa shkoj ushtar.

Në vitin 1990, Kujtimi gjen shoqen besnike të jetës, Bukurie Kolpreçin, prej fisit të Mëriturit. Zhvillimet politike të vitit 1990 e gjeten në forcat e rendit, në krahinën e Shalës, ku punoi për pak vite. Por ju rikthye biznesit privat, dhe u ba një nder specialistet e kërkuam në Shkodër e ma gjere në punimet e hekurit.

Në vitin 2000 morri rrugen e emigrimit bashke me gruan Bukurinë dhe djalin Marinin. Djali i vogël Visi mbeti nen kujdesin e nanës Linë, derisa bane bashkimin familjar mbas disa vitesh. Me vone fali zoti edhe një vajze Kristianen.

Toka e bekueme e Amerikës ishte sfondi i shpërthimit të suksesit të tij, siç duket “Amerika e mori me të mirë!”. Këtu, ai gjeti të gjitha ato që kishte ëndërrua në tokenenë. Shumë shpejt filloi biznesin me duart e arta të punimeve me hekur, dhe fale përkushtimit, ndershmërisë dhe vizionit të tij, filloi të marre sukseset e para, duke u rritur përditë deri në ndërtimin e projekteve të mëdha ku vuni emnin e tij në këto vepra, si “Funiçi Welding”.

Por si njeri i dashur dhe i

ishtë përmes mendimeve të brendshme dhe vetëreflektimit të tij në fund, që i jep tregimit një dimension psikologjik.

Në aspektin gjuhësor, teksti ka një pasuri shprehjesh popullore dhe frazeologjike, të cilat e lidhin fort me traditën orale dhe i japin ngjyrim autentik rural.

Tregimi “Shkrirje e heshtur” trajton shpërbërjen e familjes tradicionale për shkak të migrimit dhe ndryshimeve të shpejta shoqërore. Në qendër është figura e Hasan Begut, një baba i moshuar që përjeton vetminë, mallin dhe një lloj zhgënjimi të heshtur ndaj largimit të të birit dhe transformimit të marrëdhënieve familjare.

Dialogjet me Bejtën dhe personazhet e tjerë shërbejnë si pasqyrë e një debati më të gjerë shoqëror mes traditës dhe modernitetit, mes besës së dikurshme dhe realitetit të ri global. Këto pjesë kanë vlerë sepse e nxjerrin rrëfimin nga niveli personal dhe e shtrijnë në dimension kolektiv.

Përdorimi i frazave të gjata, ndërthurja e mendimit reflektiv me përshkrimin dhe ndërhyrjet filozofike e bëjnë tekstin më meditativ sesa thjesht narrativ. Mbetet një rrëfim me ngarkesë të fortë emocionale dhe me një temë që prek drejtpërdrejt përvojën kolektive të shoqërisë shqiptare në migrim.

Tregimi “Çorapja e grisur” ndërtohet mbi një bosht narrativ kujtimesh, ku dy shokë të vjetër rikthehen në të kaluarën e tyre personale dhe historike përmes rrëfimeve të ndërthurura. Autori përdor teknikën e kujtesës së rikthyer (flashback), duke kaluar nga takimi i sotëm në episodet e rinisë, studimeve, emigrimit dhe përjetimeve të dashurisë e luftës.

Në qendër të veprës qëndron motivi i kohës dhe i humbjes: koha që largon

njerëzit nga njëri-tjetri, por edhe koha që i rikthen përmes nostalgjisë. Historia e Mentorit dhe Dritonit shtrihet në dy dimensione: atë personale (kujtime dashurie, shkollore, ndjenja të paplotësuara) dhe atë historike (demonstratat, emigrimi, lufta e Kosovës). Këto dy shtresa ndërthuren natyrshëm, duke i dhënë tregimit një karakter kronikal dhe emocional.

Një nga vlerat e tregimit është ndërtimi i atmosferës nostalgjike dhe mallëngjyese, sidomos në skenat e takimit mes miqve dhe në rikthimin e kujtimeve të Xufës. Këto pjesë bartin ngarkesë emocionale dhe shërbejnë si pika kulmore të rrëfimit, ku zbulohet jo vetëm historia individuale, por edhe plagët e një brezi të tërë të shpërndarë në mërgim.

Ky është një tregim i kujtesës dhe identitetit të thyer në kohë, ku dashuria, malli dhe historia personale bashkohen në një rrëfim të gjatë nostalgjik. Vlera e tij qëndron më shumë në ndjeshmërinë emocionale dhe në temat që trajton, sesa në strukturën e ngjeshur artistike.

Tregimi “Gruaja e mashtruar” vendos në qendër figurën e Manikës, e cila përmes fatit të saj përfaqëson një realitet të njohur të varfërisë, braktisjes dhe mashtrimit bashkëshortor, duke e kthyer tekstin në një pasqyrë të dhimbshme të jetës sociale.

Nga ana tematike, tregimi trajton me ndjeshmëri çështjen e përgjegjësisë familjare, të mashtrimit emocional dhe të pasojave që lë mungesa e moralit në jetën e grave dhe fëmijëve. Figura e Lekës shërben si ndërmjetës moral: një njeri i thjeshtë, por i ndjeshëm, që reagon me dhembshuri dhe reflektim njerëzor, duke e bërë tekstin më të besueshëm dhe më të afërt me lexuesin.

Tregimi ka forcë në ndërtimin e emocioneve dhe në mesazhin human, por do

të fitonte më shumë thellësi artistike nëse drama do të shfaqej më shumë përmes veprimit dhe dialogut, e më pak përmes shpjegimit narrativ.

Tregimi “Jetimi” ndërtohet mbi një monolog të gjatë emocional, ku figura qendrore e Durim Gurit shpalos jetën e tij të mbushur me mungesa, vetmi dhe përballje të vazhdueshme me fatin. Vepra ka një bosht të qartë tematik: jetimin si metaforë e njeriut të braktisur nga rrethanat shoqërore dhe historike, jo vetëm nga familja.

Autori arrin të ndërtojë një atmosferë të ngarkuar psikologjike, ku kujtimet dhe dhimbja ndërthuren me reflektim filozofik mbi jetën, fatin dhe vetminë. Dialogu mes Durimit dhe Hasanit e forcon dimensionin human të tekstit, duke e bërë rrëfimin më të prekshëm dhe më të besueshëm. “Jetimi” është një tregim me ngarkesë të fortë emocionale dhe humaniste, që ngre një figurë universale të njeriut të vetmuar dhe të lodhur nga jeta, duke e vendosur atë në qendër të reflektimit mbi fatin njerëzor dhe pasojat e kohës.

\*\*\*

Nëse e shohim në tërësi, vëllimi i saposjellë nga autori Tahir Bezhani ka diçka të fortë: ndjenjën autentike dhe kujtesën njerëzore. Ky vëllim me tregime lindi nga nevoja për të ruajtur në fjalë atë që koha shpesh e fshin në heshtje: jetën e përditshme të njeriut të thjeshtë, përballjet e tij me fatin, dhe kujtimet që mbeten gjatë edhe kur njerëzit largohen, vendet ndryshojnë e brezat ikën.

Në qendër të këtyre tregimeve nuk qëndron ngjarja si spektakël, por njeriu si përjetim. Personazhet e këtij libri janë figura të zakonshme: prindër, fëmijë, mërgimtarë, të moshuar, miq të dikurshëm, të

ndarë nga koha apo rrethanat historike. Jeta e tyre nuk shfaqet si rrjedhë e qetë, por si një përpjekje e vazhdueshme për të ruajtur dinjitetin, dashurinë dhe kujtesën në kushte shpesh të vështira.

Tematikisht, tregimet prekin disa nga plagët më të ndjeshme të shoqërisë sonë. Në ato motive shfaqet një botë ku njeriu mbetet shpesh i vetëm përballë kohës, por jo i humbur nga kujtesa e tij. Ky vëllim nuk synon të japë përgjigje përfundimtare, as të ofrojë të vërteta të mbyllura.

Përkundrazi, ai ngre pyetje të thjeshta e të përjetshme: çfarë mbetet nga jeta e njeriut kur ikin vitet, kur largohen njerëzit e dashur, dhe kur vendi ndryshon fytyrë? Si ruhet njeriu brenda vetes kur bota rreth tij lëviz më shpejt se kujtimet?

Stilistikisht, tregimet janë ndërtuar mbi një gjuhë të thjeshtë rrëfimi, të afërt me të folurën e përditshme dhe me traditën e tregimit gojor. Kjo zgjedhje nuk është rastësore: ajo synon ta afrojë lexuesin me natyrshmërinë e jetës së përshkruar, duke e bërë rrëfimin sa më të ndjerë dhe të drejtpërdrejtë. Në disa raste, ndjeshmëria emocionale merr përparësi mbi përmbledhjen e fjalës, si një mënyrë për të ruajtur autenticitetin e përjetimit.

Ky libër nuk pretendon të jetë përshkrim i plotë i realitetit, por një fragment i tij; një pasqyrë ku reflektohen dhimbje, dashuri, humbje dhe kujtime që i përkaasin jo vetëm individit, por edhe një brezi të tërë. Këto tregime janë një përpjekje për të mos lejuar që jeta e zakonshme të mbetet e padukshme. Sepse pikërisht në të zakonshmen fshihet historia më e vërtetë e njeriut.

GJAKOVË  
24 prill 2026

◀ lidhun me njerëzit, i mungonte jeta sociale, shokët, miqtë, dashamirësit e shumë dhe kjo ishte ajo që e shtyu të merrej me industrinë e ushqimeve, me restorante, por, pa e ndërpre punën me metalet.

Kjo përben një faze tjetër e rëndësishme e jetës dhe aktivitetit të tij. Restoranti i tij, u be qendër e rëndësishme e aktivitetit komunitar e atdhetar. Priti e përcolli personalitete politike të gjithfarë ngjyre e rangut, autoritete shtetnore të Kosovës e Shqipnisë, personalitete të religjioneve të ndryshme, figura të diasporës, artistit dhe politikës lokale në New York.

Kujtimi u be miku i të gjithëve, veçanërisht e artisteve, krijuesve, producentëve. Ishte promovues i pasionuam për folklorit dhe traditës. Ai u ba iniciatori dhe organizatori kryesor i "Darkës së Dukagjinit", që e pasuroi dhe e lartësoi këngën dhe traditën dukagjinase në diasporë, për disa vite me radhe.

Kujtimi ishte aty, ku kishin nevojë shqiptaret, në punësime, në donacione, në Shqipni dhe diasporë, aty ku kishte nevojë bashkësia shqiptare, pranë njerëzve në nevojë e fatkeqësi.

Ai ishte aty ku jehonte kënga shqipe, ku ishte lahuta dhe çiftelia, me flamurin kombëtar, në ballë të oxhakut, ai ishte aty ku kishte nevojë kisha jone, si një atdhetar i flakte dhe patriot, duke bere një figure të dashtun dhe me influence për bashkësinë shqiptare të New Yorkut.

Njerëz të tille lanë boshllëk mbrapa, prandaj largimi i tij është humbje e madhe jo vetëm për familjen, por për Shalën, Dukagjinin, Shkodrën, dhe bashkësinë tone në New Yorku.

Për kontributin e Kujtim Funiçit, Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", e ka nderuar me titullin "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini".

Lisat e mëdhenj, e kane oshtimën e madhe kur bien, prandaj opinionin publik, miqtë, shokët, mediat janë të tronditur nga lajmi që u përhap si piskame deri në malet e bjeshkët e Dukagjinit, për rrugëtimin tënd të parakohshëm për në jetën e vërtetë.

Erdhe në këtë jete si "kujtim" i bukur për familjen, dhe po largohesh si kujtim i 'paharruar' për gjithë shoqërinë!

Jemi krenar, që të kishim dhe mirënjohës për gjurmët e mira, që le mbrapa, por të mërzhitur që na ike kaq shpejt!

Si besimtar, besoj që ti do të jesh prape, gardiani ynë, i familjes tende, i miqve dhe shokëve, që i deshe aq shumë!

Do të kujtojmë gjithmonë ashtu siç ishte gjalle, i dashur, i qeshur, me humor, dhe me cigare puro sa një "unë" zjermit në gojë.

Kujtim! Gjithmonë punët e vështira i bane vete, e ne, na le ato ma të lehtat. Kësaj radhe u tregove pak brutal me ne. Na le detyrën ma të vështirë, që për hatër të Zotit e pranojmë me dhimbje, me të thanë: "Lamtumire!".

Pushosh në paqe shoku ynë!

I lehte të kjoftë dheu i kësaj toke të bekueme!

I paharruar qoftë kujtimi yt o Kujtim Kola!

**DED PRENDAJ**

New York, me 11 maj 2026

# MARASH TUCI I SHOSHIT

TREGIM, nga Zef Doda

A do mik Marash Tuci! -thirri ndaj nate mysafiri i panjohur, tek i ra në derë të kullës burrit të Shoshit.

-O hajde, mirë se të ka pru Zoti! -i gjegji nga brenda i zoti i shtëpisë, duke brof në këmbë ta priste në oborr si është zakoni i maleve.

Jashtë u gjend ballë për ballë me një burrë azgan, veshur me rrobe të reja, tirq e xhamadan, mbi vetull të syrit i ulej paksa kapuçi i bardhë, si borë e malit, thue se është nisur për dasëm, o për rrugë të largët. Nën krah i rëndonte huta e gjatë vrastore kurse brezit i ngjesheshin dy calinat e bardha të tebojës së Stambollit.

-A je ti Marash Tuci i Shoshit, -i foli miku buzagaz, tek po i shtrinte dorën të faleshin atë natë për herë të parë. Sot -Unë vetë jam, or mik, -u gjegji i zoti kullës, dhe u falën faqe për faqe.

-Të kam ra sonte në konak, -tha mysafiri, dhe i shtyu pushkën të lironte krahun.

-Mirë se të ka pru Zoti, or mik, kulla e Zotit dhe e miqve është, -tha duke ja lirue krahun nga arma, dhe i priu për me hy brenda.

Në odën e zjarrit u dha dorën njerëzve të shtëpisë, pastaj zuni vend në ballë të oxhakut mbi lëkurën e dashit.

-Lirohu nga armët e brezit, si në shtëpin tënde or mik, -i tha i zoti konakut, dhe priti dy calinat e bardha t'ia varte ne zergji, pastaj i nxorri përpara qesen e duhanit. Miku drodhi

cigaren, pa u ngutur dhe filloi ta pyeste për njerëzit e shtëpisë dhe gjënë e gjallë. Marash Tuci tek ia kthente të pyeturat, po habitej me veten e tij nga i kishte kalue ky burrë që se kishte parë as njohur asnjëherë në shtëpinë e tij. Cili ishte ky kreshnik, që fliste me të matur, sikur një hall i madh e mundon në shpirt. Sa burra malesh i kishin thirrur në këtë derë, por ky jo, asnjëherë. Cili të jetë ky burrë, nga vjen e ku shkon kështu me armë shtrëngue.

Kështu e pati vra mendjen burri i Shoshit, por mikun nuk e pyeti, se miku nuk pyetet se nga vjen e për ku shkon, kështu edhe Marash Tuci nuk u ngut t'i binte kësaj rruge. Miku se ku e kishte mendjen, tek vazhdonte, me sytë ngulur atje mbi prushin e zjarrit që kërcëllinte, duke pirë duhan në heshtje. Marash Tuci nuk ia pat ënda atë shurdhësi dhe tha me vete: "Ky burrë vuan nga diçka që nuk don të hap muhabet." Ai kishte dëgjuar se ku ndeshen burrat, ndeshen orët, pra ç'të jetë. ky mik i mvrejtur?! A mund të zbuloj gjë në shpirtin e tij, për ç'rrugë është nisur....

Mysafiri nxori kutinë e duhanit dhe ia shtriu Marash Tucit, me një vështrim miqësor. Të dy burrat drodhën cigaret e dyta. Nusja e djalit solli kafet, pastaj u përkul të ushqente zjarrin që kërcëllente me dru të thata. Në ballë të vatrës një pishtar i moçëm lëshonte flakë e tym një herash nga një bangë pishash që ndizeshin vrandull.

Papritur miku ktheu kokën nga i zoti shtëpisë dhe pyeti: -Ç'të reja kemi këndeje nga fisi Shoshit, o Marash Tuci? A mba-



hen burrat hala, a kanë fillue me u lig?

Një vështrim i kryqëzuar nga një heshtje, pastaj përgjigjja. Siç duket ora e muhabetit po merrte rrugë. Marash Tuci tha: -Manet Zotit dredhun jemi tash i herë, o burrë i dheut, por falë armëve që ende si kemi lëshue nga dora.

-Orën gjallë, ishalla e keni! Pa armët krahut nuk kanë jetë këto male. Vetëm këto kanë mbetë për të ruajtë të gjallë erz e troje.

Burri i Shoshit e pa mikun në sy, me njëfarë shprese, se më në fund mysafiri e kishte hedhur një gur në shpirtin e tij. Biseda po nxirrte krye dhe Marash Tuci tha:

-Na kanë ardhë kohë të vështira, lum miku. Hyqymeti i Vezirit ka fillue me u ra në qafë malsorve. Qysh se erdhi Ibrahim Pasha, Dukagjini i është pre rruga e Shkodrës, e malet pa Shkodër nuk kanë jetë. Miku u drodh nga një trishtim i heshtur. Marash Tucit nuk i shpëtoi ai gjest tronditës.

-Për të mirë, o i zoti i shtëpisë! -e uroi mysafiri duke ulë filxhanin e kafes pranë urzakut.

-Të bëftë mirë, or mik!

Spa Nusja mori filxhanët dhe doli. Për një copë herë biseda mbeti pezull. Nën vepimin e dritës së pishës fytyrat e dy burrave kishin marrë ngjyrë të kuqërremtë, ku sajojeshin rrudhat e ballit.

-Ndryshe nga bushatllinj e tjerë, Ibrahim Pasha i ka prish lidhjet me malësorët, -tha Marash Tuci, me sundues e mizor. -maleve u ka rënë hije e zezë.hom

-Ashtu është vërtetë. Ky vezir ua ka kalue të gjithve për barbarizëm, si ka mbet asnjë dyell gjak shqiptari. Ai interesohet më shumë për haremin e jevgjitëve se për pashallëkun. Nuk durohet ma ky sundues mizor. - Marash Tuci e dëgjoi shprehjen e mikut si zërin e një alarmi të papritur dhe tha: john-Jam korit që nuk po të njoh. Burrat flasin ma lirshëm kur e dirlaore njohin njëri-tjetrin. opets agn sing in roq oferirii dun

-Nuk ke faj që nuk më njeh, o Marash Tuci, se nuk ka qëllue të shihemi ndonjëherë, e unë zanin ta kam ndigjue për burrë të fort, andaj ta kam mësy kon-

akun. Unë për veti jam Bash Vata i Nikajve. Nis jam për rrugë pa varde që s'di si ka me dalë. Mos ma merr për keq në qoftë se fsheha shpirtin e kjo erdhi se unë nuk deshta me të idhnue sonte në sofrën tande.de mul 311Thirrë e ka fisin e Nikajve Veziri për diçka të madhe. Burrat u mblodhën në kuvend, dhe më zgjodhën mua t'i përfaqësoj në fjalën e tyre. new rendirand toga deilib soviss 1919H-

-Hajr kjoftë, tha Marash Tuci, duke e ngulur vështrimin e rreptë mbi Bash Vatën e Nikajve. Në pamjen e tij qe krijuje ajo tronditje që u derdh si një bubullimë në qenien e tij dhe i tha: -Ti Bashë Vata i Nikajve?! E kush nuk ta ka ndigjue zanin ty për burrë trim e bujar. Të ma kishe thënë ka herë, bre burr, e më le në shybe gjithë këtë kohë, hë vrae zot. Ti bajraktari i Nikajve që e gëzove kullën time sonte, por edhe ma ngrive gjakun për rrugën që paske marrë.

Miku bani një buzagaz burroror. Ai s'kishte dashur t'i jepte kurrë Marash Tucit at lajm të lig. Një natë ishte ajo, dhe s'duhej t'ia shqetsonte shpirtin atij burri mikpritës, për të cilin miku ishte më i shtrëjtë se djali.

Biseda, për një copë herë mbeti pezull. Ajo ishte një heshtje ethesh, ku flitej pa folur. Ishin dy burra ball për ballë me mendime të ndryshme.

Ç'kishte ndodhur?

Lajmi i befasishëm i mikut, se ishte thirrë në Saraj të Shkodrës e kishte tronditur thellë Marash Tucin e Shoshit. Diçka e trishtë ia kishte pushtuar mendjen në ato çaste sa të kapërthurej muhabeti.

Qetësia e asaj nate qe vra. Ishte parandjenja e një fati të lig, një udhëkryq i befasishëm që kishte pjellur aq papritur tek Marash Tuci i Shoshit. Tani nuk kishte rëndësi për trimin e Shoshit, se nga vinte e nga shkonte miku i tij që i kishte rënë në konak. Ai e dinte se Ibrahim Pasha ishte prish me malet, andej nuk i thërriste për mirë. Asnjë nga ata që kishte thirrë atje nuk i kishte shpëtuar mizorisë së tij. Këtë e dinte Mash Tuci i Shoshit, prandaj i kishte rënë ajo hie e zezë. Ju duk tani se jo miku por hieja e tij i qëndronte përball. "Ç'do ky Bash Vata i Nikajve të Vezirit?", e kishte pyetur veten për të satën herë, por përgjigjja mbetej enigëm. Së fundi, mori kurajo t'i fliste! -Dredho rrugë lum miku. Brahim Pasha është i pabesë e mund të kafshojë. Si ka mbetur erz, as gjak shqiptari në deje. Sa hap një varr pret të hap një tjetër.

-Herët a vonë dikush ka për ta mbush pushkën për të, -tha Bash Vata e Nikajve duke nxjerr një gaz të keq.

-Kështu kanë thanë edhe të tjerë, o burri i Nikajve, por u doli me të pabesë. Ai thirri e preu Kelmendin, thirri e preu fise të tjera, që gabuan të kundërshtojnë. Pastaj i erdhi rradha Shalës. E di gjithë dheu historinë e pavdeksisë së tyre. U priu bajraktari i tyre, Ndre Kaltona shtat burrave, që lidhën besë e çuan armët deri në divan, por qeni, kur e pa pisk, doli dhe u la djalin për kurban. Shtatë burra qenë ata me nga dy zemra, por vdiqën edhe pse mbi Saraj krrakavit ko-

◀ rbi i zi. Ky është Ibrahim Pa-sha. -Këto male nuk janë gjytyim, sa të durojnë mbi zverk një pasha mizor, -tha Bash Vata i Nikajve. -Në mos paça fut të mirë, atëherë edhe unë kam një borxh për ta krye tek ky vezir, se më nisi fisi im për këtë mision.

Na ka lypë 300 dhen e 30 desh për traminë të bjeshkave të Boshit e të Kakisë, kurse fisi nuk don me ia dhanë e për këtë ankesë, jam nisë unë në emër të tyre. Me mue janë Deli Meshi e Deli Nika dhe Raç Uka, që vinë pas meje.

Jam nis i një mendje, o Marash. Burri nuk matet dy herë. Ti dalim edhe na Vezirit për ballë për hallet tona.

-Hajr daltë, o trim! U bëftë si ashtë ma mirë për ty e për fisin e Nikajve! -tha Marash Tuci i Shoshit, duke i vënë kapak bisedës së nisur dhe u ngrit në këmbë të shtrohej sofa e bukur.

Nusja solli ujët e duarve, pastaj mbi sofrën e shtruar u vu ibriku i rakisë dhe mezet e gjelmta të djathit e të turshive. Të dy burrat zunë vend përballë njeri-tjetrit, kallën llullat me duhan dhe ngritën gotat e para të rakisë. Nusja e re vazhdonte të ushqente pishtarin e dritës me ashkla pishe.

Biseda e ngecur ishte lidhur nye. Dy burrat pinin duhan të fortë e ndrronin ndonjë fjalë sa për të thënë. Tymi i pishës dhe i duhanit qen lidhur jezer lart në shkorcën e zjarrit. Tole

Të dy burrat, që dukej se e kishin kuptuar shpirtin e njeri-tjetrit, nuk folën me Ibrahim Pashën as për bëmat e tij ogurzeza.

Pinin raki e bënë muhabet të shtruar, për tokat e për kufitë e bjeshkëve dhe besën e gjasë e të çobanit. Gjithë këto ishin probleme jetike të mbijetesës së malësorve.

Jorn Fjalë mbas fjale dhe dy burrat e çuan muhabetin atje ku plaga mbetej hapur për gjakderdhjen vëllavrasëse midis fisesh.

Gjithë kjo dramë e kohës e kishte dëmtue e dobësue shumë fuqinë e malsorëve. Kjo pikë e zezë kishte arritur kulmin, qëkur Sulltani u pati njohur pashallarëve shqiptar të drejtën absolute mbi pronat e tokës, kundrejt një shume me para, për gjithë tokat e pashallëkut. Kështu u lihej dorë e lirë të vendosin taksa e tramina deri në livadhe e kullotat e bjeshkës të malsorëve. Kundërshtimi i hapur i tyre çoi drejt konflikteve të armatosura dhe të luftrave lokale. Ky qe Ibrahim Pasha që u grind me malsorët e rrethinave, gjer në atë masë, sa ai të mbetej në histori si përbindëshi i vezireve të Shkodrës. Ky vrasës i pabesë mbeti në legendë si më brutali i kohërave.

Rruga e vendosur për të kundërshtuar Ibrahim Pashën mbeti në histori si rrugë e pashoqe sakrificash, që bënë malsorët e të gjitha anëve për të shpëtuar nga taksat dhe haraçet që nuk përballloheshin dot.

Të dy burrat për rreth sofrës e plakën atë copë nate me kuvend, derisa i erdhi fundi darkës.

Kur u ngrit sofa dhe ndezën duhan, Marash Tuci i priu mikut të dilnin në oborr, sa nusja t'u shtronte të fjeturit në dy anët e zjarrit që nuk shuhej kurrë.

Hëna drapër kishte ba shumë rrugë në qiell.


-Duket se prap do të kemi mot të mirë,

-tha Bash Vata.

-Në deshtë Zoti! Populli ka nevojë për kohë të mirë sa ta shtien mbrend kë't bereqet.

Nusja shtroi barrën e fierit në të dy anët e zjarrit që lëshonte zuq nga gacat e buntgut. Mbi fierin e njomë hodhi dy lëkurat e deshve dhe mbulesë dy plafat e dhinte dhe gunat. Miku dhe Marash Tuci u shtrinë në të dy anët e zjarrit. Diçka i ngacmonte të mos flisnin dhe u treti gjumi, por as njeri, as tjetri nuk u ban vesht. Një punë të për-bashkët i lidhte së toku, pa e ditur se lidheshin. Ndoshta ashtu qe thënë fati i tyre. Mendonin të dy burrat për një motiv që i kishte lidhur rastësisht, por secili do të mendonte me kokën e tij. E nesërmja do të gdhinte për të dy ndryshe nga agimet e tjera të jetës së tyre.

Kënga e gjelave e gjeti Marash Tucin këmbëkryq, bri zjarrit të natës, që ende



s'ishte shuar. Pinte duhan me qetësinë e agut të ditës, sikur kishte marrë një vendim të prerë dhe tashti e kishte mendjen e pushuar.

Në anën tjetër të vatrës së zjarrit flinte ende miku me gjumin plumb. Mbase e kishte lodhur rruga e gjatë, apo qe pushuar nga ankthi i trishtë që nuk dovariste dot. Thonë se vdekja e ha njeriun shumë kohë para se t'i vijë.

Mori një urë zjarri dhe filloi të shkrepasë. Një dynja shkëndiash u shkëputën si fishekzjarre gjer në tavan të shkorcës, sa mikut i doli gjumi, por nuk u ndje për së gjalli. Njëpërmasë mëngës së gunës e vuri re Marash Tucin tek ishte

zgjuar e pinte duhan. -Nuk paska fjetur, -tha me vete tek e pa ashtu të tretun ndër mendime të zymta. I erdhi keq që ndodhi kështu. Ai burrë e kishte pritur me aq bujari, i kishte shtruar sofrën dhe së fundi kishte mësue se për ku qe nisur Bash Vata i Nikajve.

Atëherë kishte ndër të tronditjen e madhe të shpirtit sikur zjarr i kishte marrë kulla e bardhë. E kishte hetuar se diçka kishte ndodhur në shpirtin e tij. "Më mirë të kisha heshtur, siç e pata nisur", tha me vete, "por tash u bë e çdo gjë kishte marrë rrugë tjetër..."

Marash Tuci nuk kishte fjetur asaj nate, duke bluar me veten e tij ato mendime të kapërthuruna për fatin e mikut që i kishte rënë në derë gjithë ajo turbullirë sikur e kishte mbështjellë me një napë të zezë, që sa vinte e ma shumë e tmerronte. Të gjitha rrugët i kishte menduar asaj nate dhe të

kalue ndër ato mendime, së cilat fjalë do të zgjidhte t'ia thoshte Vezirit ballë për ballë. Sido që të ishte formula e tyre një kusht do të kishin: Fisi i Nikajve nuk kishte për t'i dhënë hare Vezirit të Shkodrës. Kjo qe porosia për në Saraj. Për një grusht është, Bash Vata nuk e len fjalën peng në Saraj.

Ai s'pati se ç'të mendonte tjetër atë natë dhe ja dha gjumit ndër krahë.

-Nuk paske fjetur, o Marash Tuci? -e e pa të zgjuar.

pyeti Bash Vata, kur?

-Zgjohem gjithmonë me këngën e gjelave, -qeshi me të madhe Marash Tuci.

-Më duket se paska shkue vonë. -tha miku, tek e pa djellin e ngritur. Testuable rend pro turite smarte -Ka ditë boll, bre burr. Pimë kafet njëherë.

Kur qenë krye adetet e mysafirrit Bash Vata foli: HS -Tash më duhet nisur dhe u ngrit e ngjeshi armët e brezit dhe tu epte lamtumirën.

-Mos u ngut, o burri i Nikajve, sa t'i ngjeshi edhe unë armët e mia.

-Po ti për ku? -e pyeti Bash Vata.

-Në qoftë kismet me ty në Shkodër.

Bash Vata shtangu se ç'donte Marash Tuci në Shkodër. -Pas meje, or mik!

-Po çka je tue thënë, o Marash, a e di se për ku jam nis.

-Se e di, do të vi me ty. Me kë hëngre bukën mbrenda. Marash Tuci nuk flet dy herë.

Dielli po e lante malin e Buellit të Shoshit kur dy burrat lanë pas shpine Brashdën duke çarë drejt Shkodrës.

Në hyrje të Serreqit, një han shtegtarësh për malsorë, që ndriçohej nga një fener i vjetër, priti dy udhëtarët e vonuar, që kërkonin vend për të fjetur. Hanxhiu, një thatim kokthinjur, të cilin nuk e linte rehat një koll i thatë, i priti dy udhëtarët e natës me një vështrim pyetës nga pas xhamave të gjyslykëve. Nuk ishte i gabuar që iu dukën dy bujtare, jo të zakonit, as të përshtatshëm për të bujtur në hanin e tij të shtegtarve të varfër që i sillte gryka e lindjes gjer në këtë shehër të zhurmët të bënë tregti jetike.

Të posaçdhurit, pa barrë në shpindë, të veshur e të mbathur si krushq për dasëm, jepnin pamje të rëndë.

Si kujtohej t'i kishte parë ndonjëherë në hanin e tij. I mblodhi shpejt e shpejt paratë metalike, gjer në solda, që kishin hedhur atje myshterinjt e natës për të paguar hanin. Në fund u kthye nga dy mysafirët e hanit dhe i pyeti se donin vend për të fjetur. -Po or mik duam një dhomë të dy bashkë.

Hanxhiu, si u mendua pak tha:

-Shyqyr që më ndodhet një. Në këtë kohë është vështirë të gjesh. Kemi kalballëk, -u ankua hanxhiu. -kanë ardhë kohë të vështira, Zoti e merr vesh këtë dynja.

Mysafirët e panjohur e dëgjonin tek fliste hanxhiun, që po i bezdiste. Ai sikur e kuptoi këtë teprim u tha:

-Qe po ju rregulloi edhe juve, por më falni se nuk ju njoha nga vini, apo nga shkoni.

-Edhe na malsorë, -u përgjigj burri me xhamadan. -Malësia është gjanë e gjatë mor trim, -ia priti hanxhiu. -Ec tani! -i tha me të ashpër burri me xhamadan. - Jemi të lodhur për llafe.

I zoti i hanit mori fenerin në dorë dhe i udhëhoqi përmes rru-

# Shuhet Vatrani Kujtim Funiçi!

- VATRA TELEGRAM NGUSHËLLIMI -

E nderuar familja Funiçi!  
Të nderuar vatrane e patriotë!  
I tronditur dhe me keqardhje të thellë mësova lajmin e largimit nga jeta të vatrani të përkushtuar, patriotit, aktivistit të dalluar të komunitetit tonë, mikut tim të çmuar Kujtim Funiçi. Kujtimi ishte mik fisnik e besnik, mikpritës, i papërtueshëm, zemërbardhë, shumë i këndshëm e i hareshëm, i dashur e i nderuar në mbarë komunitetin shqiptaro-amerikan.

Në emër të Federatës Pan-Shqiptare të Amerikës "VATRA", të gazetës "Dielli", në emër të të gjithë vatraneve e të familjes sime, ju përcjell ngushëllimet tona më

të sinqerta e më të dhimbshme familjes, fafesisit e miqve, për humbjen e parakohshme të Kujtim Funiçit.

Nderimi, mirënjohja dhe kujtimi do të jetë i paharrueshëm!

Të gjithë bashkë si vatrane jemi pranë familjes në këto momente trishtimi e lamtumire të pakthyeshme.

Lusim Zotin për shpirtin e tij!

Pushoftë në mbretërinë e engjëjve e të shenjtërve!

I pikëlluar në zemër

Pranë jush dhe me nderime

**Kryetari i Vatrës  
Dr. Elmi Berisha**



gicës së ngushtë që sillte erë të ndotur. Njëpër dhomëzat e hanit, mbushur me shtegtarë, ndigjoheshin gërhatjet e tyre që tregonin lodhje. Në fund të korridorit u ndal para një dere dhe e hapi.

-Ja dhoma e juaj. E ruaj për raste të veçanta, si puna e juaj. Është në fund të korridorit që most të trazohet nga zhurma e shtegtarëve, që vinë e dalin natën. Tani po ju sjell edhe tangarin me qymyr e diçka për të ngrënë.

-Mirë, -tha burri me xhamadan.

Hanxhiu doli dhe u kthye pas pak me zjarr e diçka për të ngrënë. Në rregull, apo jo, -tha tek po dilte. Me malsorët kam miqësi të vjetër, por çë do se erdhën kohë të vështira. Mbylli derën duke lanë pas zhurmën e hapave që largoheshin në terrin e natës.

Tani në han mbretëronte qetësi. Vetëm këta të dy malsorët bisedonin me zë të ultë. Ndërsa hanin darkën pranë tangarit ndezur, Bash Vata po i tregonte mikut nga Shoshi atë historinë - e të dënuarit me vdekje, kur e kishte pyetur mbreti në prag të ekzekutimit, nëse e kishte ndjer veten ma ngusht dhe ai i qe përgjigjur: "Edhe njëherë kur më ka gjet miku pa bukë në shtëpi."

-Burr i fort paska qenë, -tha Marash Tuci. Miku është më i madh se djali. Mjerë ai që e shet!

Bash Vata kafshoi buzën se kishte lënduar plagë. Në shtëpinë e të varurit nuk flitet për litar. Sed

-Të flegjmë njëherë se a shty nata vonë!

be-Mirë e ke -tha tjetri dhe hodhën dy gunat përsipër. Pas pak në dhomë dëgjoheshin vetëm frymarrja e dy burrave që prisnin agimin e ditës së re.

Ndaj të aguar, yjet e natës po korreshin njëri pas tjetrit. Nata kthente ditën e mërguar. Dalë nga dalë drita po binte e qyteti po zgjohej me zhurmë.

Të dy burrat dolën nga hani dhe ecën për një copë herë. Në një lokal pinë kafet e mëngjesit pastaj u ndanë. Bash Vata ndoqi rrugën e sarajit të vezirit. Marash Tuci i Shoshit mbeti të priste se çdo të bëhej me Bash Vatën me shokë, pa të cilin ai qe betuar se nuk dilte i gjallë në Shosh.

Zëri i një tellalli erdhi turjelë gjer në berberhane, ku po rruhej një malësor azgan, që berberit s'i kujtohej ta kishte parë ndonjë herë tjetër.

-Ç'lajm të ri po na sjell sot tellalli, -tha berberi dhe mbajti vesh, duke mbajtur

briskun e rruesit në dorë. Ai e dinte se tellalli jepte për herë lajme kobzeza.

-Hej millet! Sot pritet Bash Vata i Nikajve që kundërshtoi në emër të fisit Vezirin t'i paguaj haraçin e bjeshkëve. Vraponi në kohë dhe shihni si ndëshkohen rebelët e pabindur....-Hej millet! Sot pritet Bash Vata....

-Cili të jetë ky Bash Vata që preka sot vezirin? Pyeti kuturu berberi, dhe u përkul të rruej faqen tjetër malësorit.

-Hiqe briskun berber, hë të shiftoftë zona, se ma preu Veziri mikun dhe vetoi nga dera si shtatë herë reja, me njëren faqe pa rruar. Tek mori ashtu vrapin, mes turmës i tronditur, dukej si një luan i plagosur në fushë të hapur. remise te den Zëri i tellalit vazhdonte të thërriste. -Hej millet...guide 9m-Për hatër të Zotit kush qe ky malësor që kërcëu nga tërbimi dhe doli me një faqe pa rruar, -tha berberi, tek kishte mbetur shtang nga habia e këtij njeriu, që qe zhdukur në mes të turmës...

Tre ditë e tre net kishte pritur Marash Tuci të merrte vesh për fatin e Bash Vatës me shokë, por asgjë s'kishte mësuar. Njëqindë herë qe afruar andej rrotull sarajit se mos kapte ndonjë lajm të sigurt dhe aq herë qe larguar në pritje, me atë ankth tmerruar që e dërrmonte në shpirt. Ato kishin qenë tre ditët ma të gjata të jetës së tij.

Një shkëndi shprese e mbante të gjallë, se mund të ishte burgosur dhe rronte, ndryshe do ta kishte mësuar vdekjen e tij. Ishte endur gjithandej, por askush nuk dinte t'i thoshte për fatin e tij. Vetëm në orët e vona të natës ai shkonte e flinte te hani i malësorve në Sarreç.

Qindra mendime i vinin e i shkonin dhe se të gjitha në një pikë zinin vend. Ai në malësi të Dukagjinit nuk kishte për të dalur mikpre. Solemnitet i besës shqiptare.

"Po ku ishte, pra Bash Vata që nuk bëhej i gjallë". Kjo e mundonte. Ai nuk mund të ishte i lirë. Marash Tuci ishte në siklet. Vështrimi i egër i tij ishte aq ngulitës sa as hanxhiu s'kishte guxue ta pyes për shokun që mungonte. Ai s'kishte arritur ta kapte të vërtetën e misionit të tyre.

Atë mëngjes Marash Tuci vuri re se ishte bërë keq për t'u rruar. Kjo fytyrë e padiste për të dyshimtë, andej hyri në berberhane të rruhej....

Turma njerëzish shpejtonin pas zërit të tellallit drejt kalasë, ku do të bëhej ekzekutimi. Ishte ankthi i njerëzve, më

shumë se dëshira për të parë si derdhet gjak në kala. Ajo ishte thertorja e Vezirit ku pritëshin kokat e trimave që i kundërshtonin Ibrahim Pashës. Edhe ajo do të ishte drama e asaj dite që do të argëtonte Vezirin e çmendur bashkë me haramet e tij.

Të gjithë bënin përpara sikur nga pas shpine i shtynte një shpirt i keq. Ishte kurajoze të shihje se si ndahet një kokë e këputur nga trunghi.

Marash Tuci i Shoshit po çante turmën me duar, duke shtrënguar calinat e bardha pas brezit. Ishte miku i tij, Bash Vata, që kishte për ta argëtuar pashan zevzek. Për çudi shumë pak njerëz nga turma e kishin vënë re burrin me një faqe pa rruar se ç'donte ashtu midis tyre. Askujt s'do t'i shkonte nëpër mend se ky burrë kërkon mik te veziri.

Ashtu ecte Marash Tuci midis turmës që rritej e rritej si ortak bore. Reth vetes kapi zëra që ia tërhoqën vëmendjen. -Cilin burrë preku veziri sot?

-Thonë se një burrë, bajraktar nga fisi i Nikajve. -Po çfarë ka bë që e pret veziri.

old-Nuk i binden Ibrahim Pashës t'i paguajnë haraçin.

-Allah, allah. Kalaja e lufrave është shndrrue në kasaphanë. -Rrudhe gojën mik në mos të rëndoftë koka mbi shpatulla. -Një herë vdes burri e jo njëqindë herë si ti, -ia prit një djalosh

Marash Tuci ndjeu një pickim në shpirt. I duhej të mos binte në sy. Tani turma qe afrue pranë sheshit të ekzekutimit. Asnjëri nuk e donte vdekjen por për ta ba sehirë afroheshin e ngushtoheshin. Me këtë lloj krimi donte t'i mposhte malsorët që si bindeshin.

Marash Tuci, faqe parruar, shtyhej përpara, t'i përgatitej vdekjes në rrugë të vullnetshme. Para syve të tij qe shpallur shumë larg, fytyra e Ibrahim Pashës që gajasej midis haremeve. Burrit të Shoshit ju shfaq zemërimi i tillë e tërë urrejtja e botës qe mblehd aty.

Kordoni i zi nxorri krye tek dera e Sarajit. Në mes të zaptive të armatosur ecte Bash Vata me tre shokë Raç Ulën, Deli Meshin e Deli Nikën, ballë ngritur lart sikur shkonin në dasëm tue kap vështrimin e maleve.

Marash Tuci e pa mikun tek ecte me sytë mbi turmë, për të vështruar se ku mund ta shoh Marash Tucin, atje në oborr të kalasë.

-Hë, Bash Vata ku je trim i maleve -tha Marash Tuci dhe çau turmën me krahe të fuqishëm dhe doli në ball me një faqe e pa rruar.

-Paç fat! -i kishte thënë atë natë në han tek po pastronte armën. Me siguri ishin mashtruar nga Veziri dredharak dhe kishte mbetur brenda në mëshirën e fatit.

Askush s'e vërejt për momentin, kur të dy miqtë u pane sy me sy. Tash e dinte i sigurt se pse ndodhej atje Marash Tuci i Shoshit.

Në çast, oficeri i lartë i vezirit doli në ballë dhe turma heshti. -Me urdhër të Vezirit tone të ndritur, sot priten burrat e Nikajve që kundërshtuan në emër të fisit të paguanin haraçin e Boshit e të Kakisë prej 300 dele e 30 desh. Le të mësojnë rebelët se kështu kanë me e pague mëninë e Vezirit tonë të madh.

Xhelati ngriti çomangen dhe qëlli. Currilat e gjakut shpërthyen si shatervan nga qafa, nga goja, nga veshët e hundët. Marash Tuci, me dy calinat e bardha në duar doli nga turma dhe u turr nga sheshi si shtatë herë reja me njeren faqe pa rruar. Sytë e turmës rrëshqiten mbi këtë kreshnik legjende, njerën faqe pa rruar dhe gumëzhiu me ulurime këtë gjest stoik e të pritur: Suth-Ka dale zotni se e kam një fjalë, -ju drejtue oficerit të lart. Thuaj Vezirit se Marash Tuci i Shoshit nuk ta falë mikun. esto Një flakë e verdhë u perhap si jorgan i kuq mbi gradat e veqilit që ra përmbys tek këmbët e Bash Vatës. Merre edhe ti xhelat, për kokat që ke pre për nënat që ke veshur me të zeza, dhe Celina e dytë e shembi përbindëshin për tokë.

Një breshëri plumbash u derdhën nga zaptit e kordonit të vdekjes mbi Marash Tucin që ra i vdekur.

Turma e çakërdisur pyesnin njeritjetrin se cili qe ky dragua që la namë në Shkodër.

Kënga e kohës këndohet nëpër sekuj: Hiqe berber briskun

Se ma preu pasha mikun.

Marash Tuci i biri i vashës

S'ia fal gjakun Brahim Pashës Deli Meshi e Deli Nika,

Na nuk jemi djelm për çika Bash Vata e Raç Ula.

Në ato vorre mbiftu lula.

*Përgatiti për botim*

**Avokat SOKOL DEDNDREAJ**

# Publicisti i njohur FRAN GJOKA, njeriu që shndrit pozitivitet

"RRUGA JETËSORE PËR PLOT TË PANJOHURA E INTELEKTUALIT TË NJOHUR LEZHJAN PENA E TIJ E ARTË DO SHNDRITË MOTEVE NË PAVDEKËSINË SHQIPTARE BASHKË ME EMRIN E RESPEKTUAR" - FRAN GJOKA



Profesor Hazir Mehmeti  
Vjenë - Austri

Rruga jetësore ka përplot të panjohura dhe sfidat e saja. Veçanërisht për gjeneratat që përjetuam thyerje të mëdha kohe e sistemesh. U lindëm në robëri, u shkolluam dhe vepruam në robëri dhe tani koha e lirisë së brishtë, një shoqëri pa cak të definuar drejt progresit, sikur na gjeti me barrën e viteve. Aq më keq, shumë prej nesh u detyruam të lëshojmë përkohësisht atdheun, por si duket kurbeti do vazhdojë aq gjatë sa do pengohet edhe mundësia e kthimit të eshtrave nesër. Nga këta fatkeqë isha dhe unë, tani miku i Fran Gjokës, i atij që brenda qenies sime e pasuroi Shqipërinë, ato ëndrra që ushqenim gjithë jetën në Kosovën e përgjakur.

U njohëm nga shkrimet. Duke qenë lexues i rregullt i "Mësuesi-t", lexova me kënaqësi shumë artikuj të shkruar nga Frani. Gradualisht me sistemimin tim dhe stabilizimin në punën e mësuesisë u shtua mundësia të shkruaj artikuj nga Vjena në të njëjtën revistë ku shkruante Frani, Mësuesi-n, duke zgjedhur sadopak mungesën e Shkëndijës, bashkëpunëtor i së cilës isha dikur në fundjetën e saj, kur sulmohej çdo gjë shqiptare, gazetë e cila u mbyll nga pushtuesi serb dhe nuk e pa dritën e botimit kurrë më. Hapësira shqiptare nuk do jetë më vetëm trualli etnik, por gjithandej globit, i cili gjithnjë e më shumë u bë i vogël përkundër largësisë fizike, falë teknologjisë së komunikimit modern. Kjo mundësoi leximet elektronike në çdo cep të botës. U mundësua njohja me shumë figura nga jeta publicistike e hulumtuese përmes shkrimeve. Njëri nga disa miq, që u njohëm në formë të tillë në kohën e komunikimit elektronik, ishte edhe Fran Gjoka.

Fillimisht ishte Mësuesi që na ofroi përmes shkrimeve të Fran Gjokës e pastaj, së voni,

kur Mësuesi pushoi së foluri, lindi një margaritar tjetër kontakti, lindi Nacional, vepër e mikut tonë tani, Mujë Buçpapaj. Në Nacional rrallë mungonte prania e Fran Gjokës me shkrimet e tij përmbajtësore dhe me tema të veçanta të kapura rrallë nga të tjerët. Këto shkrime të lexuara të njëri-tjetri na ofruan derisa një ditë marr në e-mailin tim shkrimin. "Jam Fran Gjoka nga Lezha. Duke e parë punën tuaj që bëni për shkollën dhe mësimin plotësues në mërgatë, shkrimet e juaja, kontributin tuaj për shkollën në Austri, po ju dërgoj disa pyetje që të përgjigjeni. Këtë shkrim dua ta botoj së shpejti. Ju lutem mos harroni një foto portret tuajin!"

U gëzova aq shumë, sa u ngrita nga karrigia, shtyva laptopin dhe dola të meditoj sado pak në ballkonin e ndërtesës, nga i cili duken pjesë të qytetit të ndarë me Danubin lakadredhës. Mendova: "Një gazetar sikur Fran Gjoka të flasë fjalë kaq pozitive për punën time?! Tani do jem personazh i shkrimit të atij që me përvojën e tij, ndjesinë e tij në kapjen dhe rrahjen e temave ishte i shkathët, bindës dhe porosites". U ndjeva krenar i papërmbytur, fillova të lexoj pyetjet dhe mendoja në forcën time për përgjigje. Ky ishte momenti kur shtohet intensiteti kontakteve tona.

Fran Gjoka, me shkrimet e tij, ishte edhe një përvojë për mua që jetoja larg atdheut. Fillova më thellë të lexoja shkri-

met e tij, nxirrja citate në fletoren time, krahas kësaj në fantazinë time vinte figura e mikut nga Lezha, nga Shqipëria e ëndrrave mbi ëndrra. Tani Shqipëria po afrohej fuqishëm në mua dhe mezi pritja të udhëtoj verës drejt Shëngjinit, pak përtej Lezhës së Fran Gjokës, mësuesit e gazetarit të njohur. Jo shumë vonë nga shkrimet e Franit, marr një shkrim tjetër nga Lezha, nga Gjovalin Gjeloshi, agronom, gazetar, një intelektual i njohur jo vetëm në Lezhë. Kështu Lezha e Gjergj Kastriotit Skënderbeu u ngulit në mua në dashurinë e ruajtur në thellësi, ku ruhen vetëm ata që janë vetë gjeni yt, i kombit.


Ishte gusht, temperatura e lartë të zinte frymën, sidomos ne që tani ishim përshatur në ajrin e freskët që buronte nga Alpet Austriake, vendosa të le veturën dhe të nisem për Shqipëri me autobus. Në Lezhë zbres, shkrep vetëtimë aparati drejt Kalasë së Lezhës me rrënjë mbi gurët e ndrydhur, që nxirrnin kokën nga rendi i tyre dhe herë-herë dukeshin sikur do zbritnin në prehër të Mauzoleut të Gjergj Kastriotit Skënderbeu në fushëgropë.

Takimi me mikun ringjall në mua gjithë atë botë përjetimesh që kisha nga shkrimet e tij me tema të ndryshme aty ku kishte ndërë nevojën për ta dhënë fjalën shpeshherë fjalë proteste nga padrejtësitë shoqërore që shfaqeshin gjithandej vendit të liruar nga diktatura, por i futur në pështjellimet deri në anarki. Duke qenë

edhe vetë mësues, shkrimet rreth shkollës dhe sfidave të saj na lidhnin akoma më fuqishëm. Me qasjen ndaj problemeve në arsim, si sfera më e njohur e tij, e lidhur kjo nga përvoja e tij e gjatë si mësues, të lenë përshtypje që ngulitën thellë në mendje. Karakterizohet me Gjuhë konkrete të thjeshtë, por e arsyeshme në trajtimin e problemeve. Ai e ka kuptuar që herët se edukata dhe arsimimi janë pjesa më qenësore e kombit, ajo që atë e mban gjallë në rrugën e progresit. Me një mprehtësi logjike e zërthen problemin, burimin e problemit, e analizon aktualitetin akut dhe jep sugjerime për zgjidhjen e tij. Duke hulumtuar shkrimet e Fran Gjokës, tematikën dhe shtjellimin e tyre, bindesh se kemi të bëjmë me një person që jeton me problemet e shoqërisë pa urrejtje, pa fyerje, por vetëm me metodologjinë pozitive shtron zgjedhjen e tyre. Ai, me gjuhën e tij prej pedagogu e analisti, kultivon mirëkuptim e dashuri brenda

personazheve të shkrimeve të tij dhe lexuesit që e njeh, do i kthehet në bebëzat e tij pamja e Fran Gjokës, zëri i tij, qetësia e tij, e cila flet dhe të mbetet në kujtesë. Njeriu ka nevojë të ketë afër njerëz të atillë që e kuptojnë rrethin, problemet e jetës, rrjedhat shoqërore. Unë që nuk i dija nga afër në imtësi problemet e jetës në Shqipëri, më la përshtypje Fran Gjoka që në takimin e parë me të në qendër të Lezhës, ku isha për herë të parë. Sikur në mua u hapën horizonte të reja të një bote të panjohur dhe të largët, e cila më duhej shumë.

Fran Gjoka në shkrimet e tij tregon se sa i vetëdijshëm është në rolin vendimtar për progres të gruas në shoqëri, ai shpesh temë të tij ka pozitën inferiore të gruas në shoqërinë shqiptare, dhunën e ushtruar ndaj saj. E demaskon me forcë padrejtësitë që i bëhen gruas: nënës, motrës, hallës sonë, në të gjitha nivelet dhe shtresat sociale. Dhuna fizike është burim krimi, veçanërisht në familjet ku niveli i edukimit dhe arsimimit është i ulët, e theksuar kjo në zonat rurale shqiptare të izoluar nga bota. Shkrimet e tij përshkohen me gjuhën e protestës ndaj këtyre padrejtësive që e shëmtojnë jetën dhe imazhin shqiptar. Pikëpamjet patriarkale dhe inferioriteti të shprehura ndaj gruas trajtohen në disa shkrime të Fran Gjokës, duke e lidhur me gjendjen në arsim dhe edukim. Ai me të drejtë shton: "Vetëm në Shqipëri mund të ndodhë që miratohen ligje, siç është prej vitesh ai për detyrimin shkollor dhe nuk zbatohen. Arsimimi i brezit të ri dhe trajnimi i asaj kategorie me probleme për mënyrat e të jetuarit, të sjelljes dhe të vepruarit në qendra të specializuara, përbën një shans më tepër për parandalimin e krimit familjar." Në shkrimet e tij analitike, faktike, ai ngre nevojën e reformimit të shkollës, e cila ka probleme të mëdha kur shoqëria nuk merret me përmirësimin e rrethanave që e mundësojnë mësimin normal. Shtron nevojën e zbatimit të ligjit, i cili detyron përfshirjen e secilit fëmijë në shkollë brenda territorit të Shqipërisë. Ai prek afër realitetin shkollor, ku figura e mësuesit është nëpërkëmbur nga të gjithë: shteti, shoqatat, prindërit, nxënësit deri në skajshmëri, duke e kuptuar këtë si anormalitet me pasoja shkatërruese në funksionimin e shkollës, e cila objektiv ka formimin e personalitet të edukuar dhe arsimuar për shoqërinë shqiptare. Në formë të dëshpërimit, ai, mes tjerash, do shprehet: "Asnjë shoqatë, asnjë institucion, asnjë ligj nuk kemi deri tani që të mbrojmë dinjitetin e këtij intelektual të mjerë". Nga leximi i shkrimeve të Fran Gjokës, më rikthehet kujtesa tek shkolla ime dikur në Kosovën e robëruar, kur me dhunë na dëbuan forcat armike serbe nga shkollat tona dhe ne u detyruam të vazhdojmë mësimin në shtëpi private, bodrume, salla, garazhe e objekte të tjera. Po sot, përse nuk i duam, mirëmbajmë ato shkolla, nuk lexojmë dhe respektojmë mësuesin?! I bashkëngjitem revoltës së mikut tim, Fran Gjoka në gjykimet e tij largpamëse, ku shprehet brenga për kombin, të ardhmen e tij. Nuk ka të bëjë këtu me qëndrim thjesht ndaj individit, por ka të bëjë me arsimin dhe edukimin e brezave shqiptare, ka të bëjë me ardhmërinë e kombit. Kjo gjendje e shkollës shqiptare në të gjitha trevat e tij, më binte ndërmend kudo që viz-



# Triptiku i Nikollë Lokës

**SERGIO BATILDI,**

Alessandria Post, 11 maj 2026

## Perëndeshë s'je më

Me një baticë  
vij unë tek ti,  
ti ende fle  
ndër valë,  
si një sirenë  
kthyer në mit,  
perëndeshë bukëshkalë!

Me një zbaticë  
mbi trup të ndiej,  
nuk mund të të prek  
se bëhesh ujë...  
Ti je një çast,  
kujtim që dhemb!  
S'të bie në gjunjë.

E det i thellë  
mjegull u bë,  
e kaltra u bë gri.  
Baticë - zbaticë  
ti nuk je më,  
veç rërë e nxehtë,  
shkretëtirë.

## Ta kam shkruar letrën

Ta kam shkruar letrën  
mbi gjethet e vjeshtës,  
era t'i sjell  
gjethet mbi xhama.  
Këtë trishtim prej ndryshku  
më trego,  
ku do ta fshehësh  
se po t'i vret ëndrrat.

Ta kam shkruar letrën  
mbi gjethet e kaktuseve,  
e gishti  
m'u shpua në gjemba.  
Me gjakun tim  
në një re  
ta shkrova lutjen:  
mos u tremb  
prej gjethëve të rëna!

Se nën gjethet vjeshte  
gjurmë fshihen,  
gjurmë  
që të çojnë te një pishnajë,  
dhimbjen e lëshon  
mbi hala pishash të rëna.  
E ndër halishta, ëndrrat  
mund t'i thurësh me dorë.

## Mbi një ujëvarë

Vështrimin hedh mbi një ujëvarë që fle,  
dhe ujit ia heq gjumin,  
prej agut ëndrrimtar në sytë e tu,  
shkoj rrjedhës së kaltër të një lumi.

Në sytë e tu hyj fillikat i vetëm,  
si dallgë që heq dorë nga deti.



Le të më thonë pelegrin i vonuar,  
veç ta jetoj atë llad mëngjesi,  
e të zbres ujëvarash,  
ku flasin e përflasin orakuj,  
fjalë zemrash,  
ku lindin dhe vdesin fatet.

## Leximi unitar i "Triptikut"

Lëvizja e tri pjesëve është e qartë dhe e fuqishme:

Pjesa e parë: humbja dhe zhgënjimi.

Hyjnesha shpërbëhet, deti tërhiqet,  
bluja kthehet në gri, dhe mbetet vetëm  
rëra përvëluese. Është momenti i ndarjes  
dhe i vetëdijes së zhveshur nga iluzionet.

Pjesa e dytë: gjesti ekstrem i komunikimit.

Poeti shkruan letra të pamundura  
(në gjethet, gjemba, gjak, re) për të  
kapërcyer humnerën. Ka dhimbje fizike  
dhe simbolike, por edhe një shpresë  
këmbëngulëse: nën gjethet e vdekura  
fshihen gjurmë që ende mund të

udhëheqin.

Pjesa e tretë: rilindja mistike.

Nga shkretëtira dhe gjethet e rëna  
kalohet te uji që rrjedh sërish. Uni poetik  
hyn në sytë e së dashurës si një valë që heq  
dorë nga deti, bëhet pelegrin dhe zbret në  
ujëvarën ku vendosen fatet. Është rikthim

poeti të ndara, por tri stade të një shpirti  
të vetëm që e përshkon dashurinë, siç  
përshkohet një peizazh: nga deti i hapur  
te toka e thatë, deri te zbritja pastruese e  
ujit që rrjedh.

Në panelin e parë ("Perëndeshë s'je  
më") asistojmë në shpërbërjen e idealit.  
Gruaja nuk është më as perëndeshë, as  
sirenë e kapshme: me baticën e lartë  
është ende mit, me zbaticën kthehet në  
mungesë. Deti, që duhet të ishte jetë dhe  
përfaqim, tërhiqet duke lënë shkretëtirë.  
Është momenti më i dhimbshëm, sepse  
është çasti i vetëdijes se objekti i dashurisë  
është bërë i pakapshëm. Nuk ka më  
përkulje devotshmërie: mbetet vetëm rërë  
përvëluese nën këmbë.

Paneli i dytë ("Ta kam shkruar  
letrën") është sakrificë e fjalës. Poeti nuk  
dorëzohet para heshtjes së shkretëtirës.  
Shkruan aty ku është pothuaj e pamundur  
të shkruhet: në gjethet që i merr era, në  
gjemba që lëndojnë, me gjakun e vet mbi  
një re. Ka një këmbëngulje të bukur këtu,  
njëkohësisht fëmijërore dhe të shenjtë.  
Dhimbja fizike (gjembi në gisht) bëhet  
materie poetike. Dhe pikërisht në mes të  
gjakut dhe gjethëve të vdekura shfaqet  
shpresa: nën atë që bie fshihen gjurmë.  
Ëndrrat mund të enden ende me duar.

Së fundi, paneli i tretë ("Mbi një  
ujëvarë që fle") shënon rilindjen përmes  
dorëzimit. Uni poetik nuk kërkon më  
ta zotërojë detin, por hyn në sytë e së  
dashurës "si një valë që heq dorë nga  
deti". Është një imazh i jashtëzakonshëm:  
braktisja e madhështisë, e pafundësisë, për  
t'u bërë pjesë e një rrjedhe më intime dhe  
vertikale. Ujëvara që fle zgjohet, orakulli  
flet. Nga grija e panelit të parë kthehem te  
bluja, por një blu tjetër: jo më ajo e largët  
e detit, por bluja e gjallë, tingëlluese dhe e  
rrëpirët e ujit që bie.

Në përmbledhje, triptiku rrëfen  
kalimin nga një dashuri idilike dhe e  
plagosur drejt një dashurie mistike dhe  
të pranuar. Elementi uhor, qendror në të  
gjithë veprën, ndryshon gjendje: nga det  
në mjegull, në shkretëtirë, pastaj në gjethet  
të lagura dhe në fund në ujëvarë të gjallë.  
Është një alkimi i shpirtit.

Nikollë Loka na thotë, me një delikatesë  
të madhe, se ndonjëherë duhet të lejojmë  
që perëndesha të zhduket, të lëndohemi  
duke shkruar letra të pamundura, për të  
mundur më në fund të hyjmë në shikimin  
e tjetrit dhe të lëmë veten të na çojë atje ku  
lindin dhe vdesin fatet.

Iti shkolla në shumë vende me grupin e mësuesve hulumtues (Studienreise) nga Austria. Asnjëherë nuk pushuan shqetësimet, përkundrazi u thelluan akoma më shumë; sa larg jemi nga të tjerët! Vetë rezultatet e PISA-së e arsyetojnë revoltën e drejtë të mikut tim largpamës, Fran Gjoka.

Me Fran Gjokën tani e disa vite na lidhen shumë gjëra: mësuesia, publicistika, shqetësimet. Në takimin e dytë me Franin, ku ishte edhe miku ynë, Gjovalini, mësova me keqardhje mbi dhimbjen e madhe që

fsheh brenda tij miku im, Fran Gjoka. Tani e kuptova se artikullin që ai kishte shkruar për humbjen e vajzës sime, Dr. Vlorës, e cila iku në vllugun e jetës dhe sukseseve të saja, Frani e kishte ndër tërë thellë në shpirtin e tij, e kishte përjetuar po ashtu copëtim shpirti me humbjen e të vetmit djalë, krejt të ri. Me dhembje e shikova drejt në sy e në ballin e tij sikur kërkoja Franin, as tek miku i tij përballë. Ato janë thellë brenda aty ku gjaku i ushqen deri në përjetësi. E mendova, sa i fortë njeriu, sa

moral të fortë që ka dhe sikur mora forcë në qenien time. Në çdo takim, edhe pse të shkurtër, mësoja shumë nga Fran Gjoka, merrja orientim në hapësirën e nevojshme për veprime pozitive, për dashuri ndaj secilit dhe çdo gjëje shqiptare. Në të takoj mikpritjen e mikut, nderimin e tij, një virtut të trashëguar shekujve shqiptar dhe nuk mund të shpëtoja pa një dhuratë për familjen. Nuk do ta harroj kurrë mjalitin e dhuruar nga Gjovalini, me të cilin mëngjesëve hanim petullat tradicionale me familje mu në zemër të Vjenës, raki-

në e shtëpisë e pjekur dy herë e shumë të tjera. Këto takime ruhen gjatë në biseda familjare mbi traditat e shkëlqyera shqiptare për nderimin e mikut e biseda lidhje me Franin, Gjovalinin e gjithë Shqipërinë.

Të kesh një mik sikur që është Fran Gjoka, është një pasuri e madhe, një privilegj fati. Jam i bindur se vepra e tij prej mësuesi e edukatori do jetë inspirim brezave në punën e tyre. Pena e tij e artë do shndritë moteve në pavdekësinë shqiptare bashkë me emrin e respektuar Fran Gjoka.

# Prof. Dr. Vuksan Kola, margaritar i Psikiatrisë Shqiptare

- RRËFIMI I NJË PACIENTJEJE -

Dua të shkruaj për mjekun tim, psikiatrin brilant, Njëshin e Psikiatrisë shqiptare, Prof. Dr. Vuksan Kolën. Dua të shkruaj të vërtetën, si paciente e tij, të vërtetën që mbase nuk dihet, ose dihet, e heshtet.

Dua të flas për psikiatrin emblematik, ikonën e psikiatrisë shqiptare, andej e këndej kufirit, figurën e tij poliedrike prej një eruditi të vërtetë. Dua të flas për nivelin e tij kulminant e mbresëlënës intelektual, për nivelin e tij sipëran shkencor dhe për nivelin e tij qielor profesional, e të paparë në këto hapësira. Dhe patriotin shembullor që atdhedashurinë e ka jo farsë, por të pasionuar, të sinqertë dhe shumë të vërtetë!

Nuk e them kot, psikiatrin me përmasa ndërkombëtare, të cilin ndoshta nga padija, nga pavëmendja, por ndoshta edhe nga vogëlsirat tona njerëzore, sikur nuk e vlerësuam aq sa ai meriton. Dhe nuk e vendosëm aty ku ai e ka vendin, në piedestalin e psikiatrisë shqiptare.

E modestia e tij e skajshme, është vlerë për t'u vlerësuar, e jo për t'u ndëshkuar!

## MESNATA E JETËS SIME!

Sëmundja ime erdhi e fshehtë dhe pa asnjë paralajmërim. Në vitin 2000, veç tjerash edhe si pasojë e traumës së luftës. Luftës, të cilën e kisha kaluar, këtu në Kosovë. Ndjehesha fillimisht shumë e ngarkuar, tepër emotive dhe me një nervozizëm të tepruar. Nuk isha fare e vetëdijshme, se po vinin shumë shpejt, ditët më të vështira të jetës sime. Ishte kjo vërtetë mesnata e jetës sime. Nuk e kisha menduar ndonjëherë më parë, se angazhimi tepër i pasionuar dhe i përkushtuar kombëtar, përballja e vazhdueshme jo vetëm me pushtuesin, por edhe me kundërshtitë e vazhdueshme ndërshtetërore, e mbi të gjitha ankthi tremujor i luftës me intensitet aq të lartë, së bashku me gjithë problemet e akumuluar ndër vite, përfundimisht kishin ngarkuar psikën time deri në pafundësi! Ngarkesa ishte aq e madhe, sa ajo nuk mund të përballohej më.

Sëmundja ime zgjati shumë, plot 7 vjet. Këtu në Kosovë nuk pata shërim. Mjekët këtu, madje gjoja edhe ata më të mirët dështuan me mua. Një kohë u mjekova te Dr. Ferid Agani. Më vonë kuptova se edhe diagnoza edhe terapia që ai më kishte dhënë, ishte e gabuar. Vëreja që ai përpiqej të më orientonte nga feja islame, gjoja për të më shëruar. Edhe pse i kisha thënë, se unë ndjehesha e krishterë. Bëhesha çdo ditë e më keq. Ndërkohë që vuaja një sëmundje të rëndë, me emër të njohur dhe me terapi po ashtu të njohur. Ai një kohë të gjatë abuzoi me trurin tim, me ose pa qëllim, duke më futur në vorbullën e efekteve tmerruese të ilaçeve joadekuete. Vlerësimi im nuk ishte pa bazë. Është ky në fakt vlerësimi i specialistëve tjerë, që ma thanë këtë. Vazhdoja të kërkoja dhe të vizitohesha sa te një, sa te psikiatër tjetër. Ndërrova afër dhjetë psikiatra të ndryshëm në Kosovë. Jo vetëm nuk gjeta shërim, por sëmundja ime sa vinte e rëndohej. Dita ditës bëhesha më keq. Kur për mua më nuk kishte asnjë shpresë, pas 7



vjet zvarritjeje që më bënë këta injorantët këtu, që psikiatër veten e quajnë, Zoti më çoi në Tiranë. Aty ku gjeta shpëtimtarin ti, Prof. Dr. Vuksan Kolën! Pasi, që gjithçka kishte mbaruar për mua, Zoti, e Prof. Dr. Vuksan Kola më shpëtuan!. Atëherë, kur unë isha vërtetë e mbaruar dhe kur për mua më nuk kishte asnjë shpresë, pas disa vitesh të gjata tmerrri e ferri.

Doktori vlerësoi saktë sëmundjen time, lexoi qartë karakterin dhe temperamentin tim, identifikoi shkaktarët, dhe më dha terapinë e duhur.

Sapo e pashë doktor Vuksanin, për herë të parë, sapo mu drejtua, në mënyrë të prerë, tepër serioze dhe të vendosur, me një qëndrim që impononte, se si rrufeshëm, u ngjall te unë besimi. Besimi, që nuk e ndjeva asnjëherë te asnjeri nga ata psikiatër që më kishin vizituar më parë. Pas tri ditësh trajtimi, u panë shenjat e para të përmirësimit. Ehh, sikur ta kisha njohur më parë doktor Vuksanin! E sikur t' a kisha pasur fatin që t'i drejtohesha 7 vjet më parë e të shpëtoja nga ferri i Dantes dhe të shpëtoja 7 vitet më të mira të jetës sime. Jetoj me bindjen e thellë, që ky mjek, brilant në fushën e tij, do të mund, madje, edhe ta parandalonte sëmundjen time, akoma pa ardhur, vetëm po të kisha fatin ta takoja para sëmundjes.

Ky njeri, lexoi shumë shpejt personalitetin tim, karakterin dhe temperamentin tim dhe natyrën time aspak të lehtë! Menjëherë pas pak minutash, ai mu drejtua në mënyrë të prerë, madje autoritare, dhe në çast ai fitoi besimin dhe respektin tim të pakufishëm. Madje edhe atëherë, kur isha në atë gjendje të tmerrshme. Kur mori vesh që isha inxhinieri e kimisë, e para që më tha, po ashtu në mënyrë të prerë, në fakt si urdhër, ishte se unë fare nuk do të guxoja të lexoja e të merresha me udhëzimet e ilaçeve dhe të përpiqesha të bëja mjekun e psikiatrin me njohuritë e mija të kimisë. "Ti do t'i marrësh ilaçet ashtu siç do të them unë" - më tha- pa asnjë dilemë

dhe në mënyrë të disiplinuar. Profesionalizmi i tij, qëndrimi i tij, vendosmëria, qasja ndaj pacientit dhe psikologjia e personit tim nga ai, shumë shpejt rezultuan, atëherë kur tanimë unë isha fundosur thellë në humnerë, dhe i kisha humbur të gjitha shpresat se do bëhesha mirë ndonjëherë.

Unë e them sot, e do e them përherë, se doktori më fali jetë. Unë jetoj falë tij! Dhe, them po ashtu, se çfarëdo që bëra për këto 20 vjet të falura nga ai, janë vetëm e vetëm meritë e tij dhe jo e imja.

Suksesi i doktorit me mua nuk ishte i rastit, sepse te ai janë të ndërthurura në mënyrë të pasosur, thuaja simfonike, niveli sipërm profesional, ai intelektual dhe shkencor, si te asnjë tjetër. Veç tyre etika, qëndrimi ndaj pacientit, sjellja e duhur, fjalët e pakta, të prera dhe të vendosura, personi i tij që imponon, leximi i saktë i personalitetit të pacientit, besimi që ai ngjall te pacienti, me një fjalë një ndërthurje komplekse e të gjitha cilësive dhe virtyteve sipërme, e bëjnë atë një psikiatër model. Dhe sigurisht, cilësitë dhe virtytet e veçanta të tij, bashkë me trajtimin e duhur terapeutik, të gjitha së bashku, kanë vetëm një rrugë dhe një emër: Atë të suksessit dhe shërimit. Edhe atëherë kur njeriu nuk sheh dritë dhe nuk sheh shpresë.

Unë e them me bindje të plotë, se as psikiatrit më të dëgjuar e të respektuar të Shqipërisë, për të cilët di dhe kam dëgjuar, pra as figurat më të shquara të psikiatrisë shqiptare, asnjeri prej tyre, as individualisht dhe as si konsilium, mua nuk do të mund të më ndihmonin, ashtu siç më ka ndihmuar mjeku im, psikiatri ikonik, Prof. Dr. Vuksan Kola.

Psikiatri matet me suksesin që tregon me pacientët. Profesor Vuksani tregoi sukses të jashtëzakonshëm jo vetëm me mua, por edhe me shumë pacientë të tjerë, që më ka rastisur t'i njoh me emër e mbiemër. Dhe me një numër të madh të familjarëve të mi, që të tjerët nuk mund t'a bënin. Kur gjithë të tjerët dështuan, me mua dhe me shumë pacientë të tjerë, ishte Dr. Vuksani ai i cili na dhuroi shërimin! Sa shumë njerëz i ka nxjerrë nga ferri, ky psikiatër mendjendritur, psikiatër i përmasave ndërkombëtare.

Ndër ta, dua të përmend këtu, dy nga disa familjarët e mi, të gjithë pacientë të Dr. Vuksanit. Veçoj këta dy familjarë të mi, sepse ata, nuk gjetën shpëtim as në Amerikë, në klinikat më të dëgjura e më prestigjioze, e më të shtrenjta amerikane. Shpëtimin e gjetën në Shqipëri te Profesor Vuksani.

Unë me të drejtë e quaj shpëtimtarin tim! Njeriun që më fali jetë, kur për mua gjithçka kishte mbaruar. Me bindje të plotë them, se nuk ka më të merituar në fushën e psikiatrisë shqiptare, se Prof. Dr. Vuksan Kola, as në Shqipëri, as në Kosovë dhe as në mbarë Shqipëtarinë. Kjo nuk është vetëm përvoja dhe as vetëm mendimi im. Janë shumë pacientë, të trajtuar te ai, që kanë njohur suksesin dhe shërimin, pasi kanë kaluar te shumë psikiatër tjerë, para se të arrinin te doktor Vuksani. Unë vet kam kaluar dhe kam provuar shumë psiki-

atër, të cilët jo vetëm kishin dështuar me mua, por gjendjen time të rëndë e kishin rënduar edhe më shumë.

Për Prof. Dr. Vuksan Kolën, mund të kem vetëm respekt, vetëm nderim, vetëm vlerësim pakufi dhe mirënjohje, mirënjohje të përjetshme!

Unë dhe pyes tani, si është e mundur që një kapacitet madhor si Prof. Dr. Vuksan Kola, e një figurë emblematike si ai, nuk është sot Akademik. Çfarë vlerësimesh makabre janë këto?! Unë nuk besoj se në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, të ketë akademikë me bagazh më të fuqishëm shkencor, profesional, intelektual e pedagogjik se Prof. Dr. Vuksan Kola. Me një pjesëmarrje intensive në Kongrese, Konferenca Ndërkombëtare dhe referime, të aq shumë punimeve e publikimeve shkencore dhe profesionale, në revistat më prestigjioze ndërkombëtare, si dhe me një aktivitet botues shkencor e profesional aq të dendur përveç specializimeve të shumta shkencore dhe profesionale në shumë vende të botës. Thjesht nuk e besoj! Mbase! Pjesëmarrës në mbi 45 Kongrese dhe Konferenca Ndërkombëtare, dhe referuar në 15 prej tyre. Kush sipas tyre meritua titullin Akademik, nëse jo një shkencëtar e një profesionist Par Excellence si Prof. Dr. Vuksan Kola. Apo edhe në Shqipëri, ashtu si edhe në Kosovë, emërimet bëhen me hatër, me miqësi e krushqi dhe me çelësa partiak si në Kosovë?!

Një psikiatër si ai, që ka në dorë mendjet dhe shpirtat e shumë njerëzve hallexhinj, dhe një psikiatër I provuar dhe i dëshmuar si ai, meriton gjithë kujdesin, vlerësimin, vëmendjen dhe mirënjohjen jo vetëm të institucioneve shëndetësore, por edhe të vetë shtetit dhe institucioneve më të larta shkencore dhe shtetërore.

Puna e tij shumëvjeçare në kurimin dhe kthimin e suksesshëm në jetë, të shumë pacientëve me sëmundje serioze, është e pamatshme, ka vlerë të veçantë, dhe edhe pse secila punë ka vlerën e vet. Kjo punë pra, është e pakrahasueshme me punët tjera. Ju mbase nuk e dini se sot, në Kosovën e pasluftës, kemi një shoqëri dhe një kolektivitet të sëmurë, me simptoma të rënda të stresit posttraumatik. Mbase nuk e dini se numri i atyre njerëzve në Kosovë, që vuajnë traumat e luftës është enorm! Dhe po të kishte shtet te na, e po të kishte institucione kredibile shëndetësore, korrekte dhe serioze, që kanë hallin e hallexhinjve, ato do të duhej t'i përgjroheshin profesor Vuksanit që të paktën, një herë në muaj t'i trajtonte njerëzit që nuk i flakën asnjëherë traumat e luftës. Kjo gjendje kolektive në Kosovën e pasluftës, ka eskaluar jashtë çdo mase dhe është bërë sindromë. Por institucioneve tona shëndetësore dhe shtetërore, aq u bën për këtë rëndesë kolektive psikologjike, që fundja cenon mirëqenien e tërë shoqërisë.

Në fund dua të them, me bindjen e plotë dhe me sinqeritetin më të madh se psikiatri i nderuar Prof. Dr. Vuksan Kola është aset e thesar kombëtar! Të tillë nuk quhen vetëm heronjtë e luftës! Të tillë janë edhe heronjtë e paqes! Heronjtë e punës e të përkushtimit, heronjtë e idealit, pasionit dhe të vetëmohimit, heronjtë e luftës për mirëqenien e shoqërisë, heronjtë e shpëtimtarët e jetës së njeriut! I tillë është Prof. Dr. Vuksan Kola.

Ai nuk është vetëm nderi i Dukagjinit dhe nderi i Shkodrës! Ai është nderi i Kombit, gjithë Shqiptarisë!

Prof. Dr. LULJETA PULA,  
Prishtinë, me 5 maj 2026



MUNDËSOI BOTIMI,  
Prof. Dr. LULJETA PULA,  
PRISHTINË

## REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj  
Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri,  
Suela Ndoja, Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia  
Dushi, Leke Sokoli, Edmond Tërthorja, Lulash Brigja,  
Vilson Peshkaj, Prele Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza,  
Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.